



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
K R Y E T A R I

Adresa: Rruga Rruga "Abdi Toptani" Nr. 1 Tiranë.

E-mail: klsh.org.al; ëeb-site:ëëë.klsh.org.al

Nr. 1269/_Prot.

Tiranë, më 19.12.2018

V E N D I M

Nr. 212 , Datë 19.12.2018

PËR

AUDITIMIN E USHTRUAR NË 4 SUBJEKTE TË AUDITUARA PËR VERIFIKIMIN E ZBATIMIT TË REKOMANDIMEVE TË LËNA NË AUDITIMET E MËPARSHME TË EVADUARA PËR PERIUDHËN 01.01.2018 DERI 30.05.2018, RESPEKTIVISHT NË 4, BASHKITË: BASHKIA KAMËZ, BASHKIA RROGOZHINË, BASHKIA PRRENJAS DHE BASHKIA BELSH”

Pasi u njoha me Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe projektvendimin e paraqitur nga Grupi i Auditimit të Departamentit të Auditimit të Njësisë të Vetëqeverisjes Vendore, shpjegimet e dhëna nga subjekti i audituar, mendimin për cilësinë e auditimit nga Drejtori i Drejtorisë së Standardeve dhe Sigurimit të Cilësisë, vlerësimin mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit të Auditimit të mësipërm dhe Drejtori i Përgjithshëm, në mbështetje të neneve 10, 15 dhe 30, të ligjit 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”,

V E N D O S A:

I. Të miratoj Raportin Përfundimtar të Auditimit “Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme të evaduara për periudhën 01.01.2018 deri 30.05.2018”, të ushtruar në 4 Bashkitë respektivisht: **Kamëz, Rrogozhinë, Prrenjas dhe Belsh**, sipas programit të auditimit nr. 1269 Prot., datë 14.11.2018 dhe autorizimin nr. 1269/5, datë 21.11.2018, të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit.

II. Të miratoj rekomandimet e përcaktuara dhe të kërkoj marrjen e masave, për sa vijon:

a-Mbi kthimin e përgjigjes të zbatimit të rekomandimeve të KLSH brenda afatit 20 ditor, hartimi i Planveprimeve (programeve) të punës dhe raportimi në KLSH mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afatit 6 mujor.

Nga 4 bashkitë e verifikuara, 3, kanë kthyer përgjigje KLSH-së, brenda afatit ligjor prej 20 ditëve, duke hartuar edhe planet e veprimtari (programet e punës), ndërkohë vetëm subjekti Bashkia Belsh nuk ka raportuar në KLSH me shkrim mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afatit 20 ditor dhe 6 mujor, në kundërshtim me nenin 15 dhe me pikën 2 dhe nenin 30 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", ku përcaktohet se: "Kontrolli i Lartë i Shtetit, sipas rastit, në fillim, përgjatë dhe/ose në përfundim të veprimtarisë, duhet: j) të vendosë një afat kohor për zbatimin e rekomandimeve dhe të informohet nga subjektet e audituara ose institucionet më të larta rreth programeve të tyre, për të zbatuar rekomandimet e bëra sipas paragrafëve të mësipërm, brenda 20 ditëve nga data e marrjes së kërkesës. Subjekti i audituar, brenda 6 muajve nga data e njoftimit të raportit të auditimit, i raporton Kontrollit të Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të dhëna".

b-Mbi raportimin rregullisht në Këshillin Bashkiak të ecurisë të zbatimit të rekomandimeve të KLSH, siç përcaktohet në nenin 50 -Auditimi i jashtëm, pika 5, të ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore".

Nga verifikimi rezultoi se nga subjektet e audituara, detyrimin për të raportuar në Këshillin Bashkiak nuk e ka zbatuar vetëm Bashkia Belsh. Duke mos zbatuar ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", Neni 50-Auditimi i jashtëm ku përcaktohet se: 5. Për të gjitha raportet e auditimit të jashtëm, të kryera nga Kontrolli i Lartë i Shtetit apo auditues të tjerë ligjorë, kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore përgatit një plan veprimi për zbatimin e rekomandimeve të raportit të auditimit dhe raporton rregullisht në këshillin e njësisë.

Realizimi i zbatimit të rekomandimeve sipas llojit të tyre paraqitet si më poshtë:

A. MASA ORGANIZATIVE:

Nga auditimi i realizuar në 4 subjektet e verifikuara për zbatimin e detyrave dhe masave të rekomanduara në auditimin e evaduar për periudhën 01.01.2018 deri 30.05.2018, rezultoi një nivel i pranueshëm zbatueshmërie në masën 100%, nga 66 masa organizative të rekomanduara janë pranuar të 66 masat. Nga masat e pranuar janë zbatuar plotësisht 23 masa ose në masën 35 %, nuk janë zbatuar 12 masa në masën 18 %, ndërsa 31 masa në masën 47 % janë në proces zbatimi, pra në një total prej 66 masash organizative. Subjekti i cili nuk kanë zbatuar masat organizative të rekomanduara nga KLSH përmendim Bashkinë Blesh me 12 masa.

(Në mënyrë të detajuar realizimi i masave organizative paraqitet në Aneksin nr. 1, bashkëlidhur këtij Vendimi)

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI:

Në 4 subjektet e audituara për zbatimin e detyrave dhe masave të rekomanduara në auditimet e evaduar për periudhën 01.01.2018 deri 30.05.2018, konstatohet se nga vlera e rekomanduar për shpërblim dëmi prej 118,528 mijë lekë të cilat janë pranuar në masën 23%, janë arkëtuar deri në datën 30.10.2018, 13 masa në vlerën 2,194 mijë lekë, prej tyre janë në proces gjyqësor apo kanë dalë urdhrat e ekzekutimit, pra janë në proces zbatimi 8 masa në vlerën 20,812 mijë lekë, duke mos u pranuar apo pa mundësi arkëtimi 35 masa shpërblim dëmi në vlerën prej 91,576 mijë lekë në masën 56 %, respektivisht:

-**vlera prej 9,877 mijë lekë** i përket Bashkisë Rrogozhinë pjesa më e madhe e të cilave lidhet me shpenzimet e karburantit të pa justifikuara me dokumentacion në lidhje me harxhimin e tyre apo shpenzime për akomodimin dhe transportin e futbollistëve duke shkelur disiplinën financiare me pasojë dëm ekonomik etj.

-**vlera prej 78,975 mijë lekë**,i përket Bashkisë Belsh,për të cilat nuk është marë asnjë masë për arkëtimin e vlerës së rekomanduar nga KLSH me arsyetimin se disa nga këto çështje i janë referuar organit të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Elbasan. etj.

(Në mënyrë të detajuar realizimi i masave për shpërblim dëmi paraqitet në Aneksin nr. 1, bashkëlidhur këtij Vendimi)

C.MASAT DISIPLINORE DHE ADMINISTRATIVE:

Në 4 subjektet e verifikuara për zbatim të rekomandimeve nga KLSH janë rekomanduar masa administrative apo masa për fillimin e procedurave disiplinore për **83 masa,nga të cilat** nuk ka masa të papranuara, duke u pranuar **83 masatë** cilat janë shqyrtuar në komisionet disiplinore apo APP dhe prej tyre janë zbatuar **63 masa** ose në nivelin **76%**, duke mos u zbatuar **18 masa** ose në nivelin **2 %**, të cilat i përkasin Bashkisë Rrogozhinë. Janë në proces zbatimi edhe 18 masat e vendosura nga APP për Bashkinë Belsh për të cilat është bërë vetëm njoftimi i personave por nuk janë kontabilizuar veprimet.

(Në mënyrë të detajuar realizimi i masave disiplinore dhe administrative paraqitet ne Aneksin nr. 1, bashkëlidhur këtij Vendimi)

Ndërsa realizimi i rekomandimeve për secilin nga 4 subjektet në mënyrë të detajuar paraqitet si më poshtë:

1.BASHKIA KAMËZ:

- Nga verifikimi rezulton se KLSH ka dërguar në Bashkinë Kamëz rekomandimet e auditimit me shkresën Nr.1298/9 Prot, datë 19.04.2018, protokolluar në Bashkinë Kamëz me shkresën nr. 2182 Prot, datë 23.04.2018, ndërsa nga Bashkia Kamëz për zbatim e rekomandimeve të KLSH është kthyer përgjigje me shkresën e saj nr.2182/1 datë 11.05.2018, protokolluar në KLSH me shkresën nr.1298/13 datë 17.05.2018. Përgjigja e Bashkisë për zbatimin e rekomandimeve të KLSH është **bërë brenda afatit ligjor të kthimit të përgjigjes.**

- Nga verifikimi rezulton se përfundimet e auditimit i janë dërguar subjektit të audituar Bashkisë Kamëz, me shkresën e Kryetarit të KLSH nr.25, datë 17.04.2018 dhe duhet të raportonte në KLSH brenda 6 muajve ose brenda datës 19.10.2018 (referuar nenit 30, pika 2 e ligjit nr.154/2014 datë 27.11.2014 “Për funksionimin dhe organizimin e KLSH, për raportimin brenda 6 muajve nga marrja e njoftimit të RPA).Nga Bashkia Kamëz është përgatitur dhe dërguar pranë KLSH, Raport me shkrim “Mbi zbatimin e rekomandimeve të Raportit Përfundimtar të Auditimit të KLSH”, e protokolluar me shkresën nr. 2182/2, datë 16.10.2018, **pra është raportuar brenda afatit.**

-Nga verifikimi rezulton se Bashkia Kamëz ka hartuar planin e veprimit të zbatimit të rekomandimeve të dërguara nga KLSH me shkresën nr. 2182/1 prot datë 10.05.2018, ndërkohë ka raportuar në këshillin e njësisë (këshillin bashkiak), ku ka paraqitur “Relacion për Këshillin Bashkiak”, protokolluar me shkresën nr. 3885 prot. datë 13.07.2018 dhe nr. 5053/1 prot. datë 03.10.2018, bazuar në ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, Neni 50-Auditimi i jashtëm ku përcaktohet se; 5. *Për të gjitha raportet e auditimit të jashtëm, të kryera nga Kontrolli i Lartë i Shtetit apo auditues të tjerë ligjorë, kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore përgatit një plan veprimi për zbatimin e rekomandimeve të raportit të auditimit.*

A. MASA ORGANIZATIVE:

Nga KLSH i janë rekomanduar Bashkisë Kamëz 17 masa organizative, të cilat janë pranuar dhe prej tyre, janë zbatuar plotësisht 13 masa, nuk ka masa organizative të pa zbatuara , ndërkohë që janë në proces zbatimi 4 masa organizative për të cilat rikërkojmë zbatimin e masave si vijon:

1.4. Gjetje nga auditimi:

a. Në Bashkinë Kamëz, në fund të vitit 2017 rezultojnë debitorë për taksa dhe tarifa vendore 201 subjekte të biznesit të vogël dhe 47 Subjekte të biznesit të madh për të cilat llogaritet mungesë të ardhurash **në vlerën 49,781,264 lekë.**(Nga të cilat për vlerën 5,016,666 lekë, nga ish Komuna Paskuqan)

b.Nga auditimi mbi vjeljen e detyrime për tatim taksat lokale, konstatohet se nga Bashkia Kamëz, nuk janë marrë masa të veçanta lidhur me vjeljen e taksës së ndikimit në infrastrukturë në vlerën prej **285,035,451 lekë**, për objektet ndërtimore që legalizohen nga ALUIZNI- Drejtoria e Tiranës. Sipas të dhënave zyrtare që ALUIZNI i ka dërguar Bashkisë Kamëz, konstatohet se nga muaji Qershor i vitit 2014, janë posedues të lejes së legalizimit që nuk kanë paguar detyrimet për taksën e ndikimit në infrastrukturë dhe tarifën përkatëse 4,226 persona për sipërfaqe ndërtimore të legalizuar gjithsej 900,908 m² nga të cilat 841,739 m² për banim dhe 59,168 m² për aktivitet social ekonomik.

Vlera totale e pa arkëtuar është **285,035,451 lekë, e ardhur e munguar** nga të cilat 130,020,768 lekë taksa e ndikimit në infrastrukturë dhe 155,014,683 lekë tarifa për planet vendore.

c.Në Bashkinë Kamëz, kanë ushtruar aktivitet 45 subjekte pa qenë të regjistruar në QKB, për të cilat llogaritet **mungesë të ardhurash në vlerën 2,082,685 lekë,** (Bashkia Kamëz, për 54 subjekte në vlerën 1,976,251 lekë, Njësia Administrative Paskuqan, për 10 subjekte në vlerën 106,434 lekë).

Përsa më sipër, nuk janë zbatuar kërkesat e ligjit nr. 9482, datë 03.04.20106, “Për legalizimin urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje” i ndryshuar me nr. 50/2014 neni 23, ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore” të ndryshuar”, VKM nr. 860, datë 10.12.2014 “Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe veprave të zbatueshme për legalizimi” i ndryshuar dhe Vendimi i Këshillit të Bashkisë nr. 140 datë 23.11.2016 “Për miratimin e taksave e tarifave vendore të bashkisë për vitin 2017”.

Drejtoria e Tatim Taksave Bashkia Kamëz për arkëtimin e debitorëve të taksave vendore dhe taksës ndikimit në infrastrukturë, nuk ka ndjekur procedurat e nevojshme ligjore, veprim në kundërshtim me nenin 4, 26, 32, 34, të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, nenet 40, 41 90, 91, të ligjit nr. 9920 ”Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar dhe nenin 12, të UMF nr. 24, datë 02.09.2008, Kreu i XI-Mbledhja me forcë e detyrimeve” (trajtuar më hollësisht në faqet 125-142 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.4.1. Rekomandimi: Drejtoria e Tatim Taksave në Bashkinë Kamëz, bazuar në nenin 70 pika 3 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në RSH” i ndryshuar të marrë masat për arkëtimin e detyrimeve tatimore duke bërë njoftim vlerësimet tatimore:

-për 201 subjekte të biznesit të vogël dhe 47 Subjekte të biznesit të madh debitorë **në shumën 49,781,264 lekë** dhe

-për 4,226 persona në vlerën totale të pa arkëtuar prej **285,035,451 lekë, e ardhur e munguar** nga të cilat 130,020,768 lekë taksa e ndikimit në infrastrukturë dhe 155,014,683 lekë tarifa për planet vendore.

Duke ndjekur rrugët e mëposhtme:

a- Tu dërgohen bankave (subjekteve që nuk u është dërguar) urdhra bllokimi për llogaritë bankare, bazuar në nenin 90, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

b- Të dërgoj në Drejtorinë Rajonale të Transportit, kërkesa për vendosjen e barrës siguruuese (për mjetet) dhe në Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, bazuar në nenin 91, të

ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.

c- Për subjektet të cilët nuk paguajnë detyrimet tatimore në afat, të llogaritet kamat vonesa (gjobë në masën 0,06 %, kamat vonesë të detyrimit në ditë por jo më tepër se 365 ditë), bazuar në nenin 114, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.

d- Në rast se bizneset private edhe pas njoftimeve zyrtare dhe dërgimit të urdhër bllokimeve në bankë, nuk kryejnë pagesën e detyrimeve, bazuar në nenin 182, të ligjit të Kodit Penal në RSH i ndryshuar, pasi të vendosen masa administrative, të bëhet kallëzim penal.

1.4.2. Rekomandimi: Drejtoria e Tatim Taksave në Bashkinë Kamëz të marrë masa, të njoftojë zyrtarisht Drejtorinë Rajonale Tatimore duke kërkuar regjistrimin në QKB të 45 subjekteve dhe të kërkojë në rrugë ligjore dhe administrative arkëtimin e detyrimeve në vlerën **2,082,685 lekë**.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

2.8. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi aktivitetin e Ndërmarrjes së Ujësjetllës Kanalizimeve që është në vartësi të Bashkisë Kamëz, konstatohet performancë e ulët në vjeljen e detyrimeve nga abonentët:

-**Për vitin 2016**, të ardhurat janë realizuar në masën 155,423 mijë lekë ose 68% e programimit. Numri i abonentëve gjithsej është 15,968 abonentë, kurse gjendja e debitorëve është 6,698 abonentë për vlerën **85,826 mijë lekë**.

-**Për vitin 2017**, të ardhurat janë realizuar në masën 197,538 mijë lekë ose 66% e programimit. Numri i abonentëve gjithsej është 22,519 abonentë, kurse gjendja e debitorëve është 4,364 abonentë për vlerën 84,333 mijë lekë (*trajtuar më hollësisht në faqet 153-165 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

2.8.1. Rekomandimi: Nga Ndërmarrja e Ujësjetllës Kanalizimeve, të merren masat e nevojshme për arkëtimin e plotë të detyrimeve debitorë, duke hartuar programe pune, lajmërimin e abonentëve debitorë dhe masa të tjera administrative.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

3.13. Gjetje nga auditimi: Nga Bashkia Kamëz, nuk janë ndërmarrë hapat ligjore për regjistrimin e pronave në pronësi të Bashkisë në ZVRPP Tiranë, në kundërshtim me zbatimin e kriterëve dhe procedurave të përcaktuara në VKM nr. 500 datë 14.08.2001 "Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore" i ndryshuar (*trajtuar në faqe 152-153 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

3.13.1 Rekomandimi: Bashkia Kamëz të marrë masat e nevojshme për regjistrimin e pronave dhe për krijimin e regjistrit të pronave të paluajtshme të kaluara në pronësi, apo në përdorim të Bashkisë Kamëz.

Menjëherë

4.14. Gjetje nga auditimi: Për të gjitha asetet nuk është hapur regjistri kontabël, në kundërshtim me kapitullin III "Regjistri i aktiveve dhe dokumentimi i lëvizjes së tyre", pika 26 dhe 27 të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", pasi nëpunësi autorizues nuk ka caktuar nëpunësin zbatues për krijimin dhe mbajtjen e regjistrit kontabël të të gjithë aktiveve që zotëron apo ka në administrim Bashkia Kamëz. Po kështu në kundërshtim me pikën 31/d të udhëzimit të mësipërm, nuk është mbajtur regjistri i veçantë për secilën nga pasuritë e dhëna me qira ku të përcaktohet sipërfaqja e objektit në metra katrorë, numri dhe data e kontratës së qirasë, afati i vlefshmërisë së kontratës, afati i qirasë, veprimtaria që kryhet, subjekti përfitues, qiraja mujore dhe arkëtimet sipas muajve të vitit kalendarik (*trajtuar në faqe 152-153 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

4.14.1 Rekomandimi: Bashkia Kamëz, pas azhurnimit të aseteve të kaluara në pronësi me VKM nr. 1032, datë 08.10.2009 dhe aplikimit për regjistrim në ZVRPP Tiranë në pronësi të Bashkisë, përkatësisht në regjistrin e kartelave të pasurive të paluajtshme, të krijojë dhe mbajë regjistrin

kontabël të tyre, si dhe të përditësojë regjistrin mbi pasuritë e paluajtshme të dhëna me qira, qofshin këto në format e trualli të lirë, apo të pajisur me infrastrukturë.

Në vazhdimësi

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI:

Bazuar në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” neni 15 germa (b) dhe (c) –*Të drejtat e KLSH* dhe mbështetur në nenet 98-102, të ligjit nr. 44/2015, datë 30.04.2015 “Kodi i procedurave administrative në Republikën e Shqipërisë”, nenet 21-33, të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” dhe pikën 93, të udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 ”Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, nga **Titullari i njësisë publike**, të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore (Padi Gjyqësore) duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit. **Nëpunësi zbatues** të ndjekë procesin me qëllim shpërblimin e dëmit në **vlerën 3,375,978 lekë**, si më poshtë:

b. Për shpërblim dëmi janë rekomanduar 6 masa me vlerë 3.375.978 lekë, është pranuar dhe kontabilizuar e gjithë vlera dhe deri me datë 30.11.2018, nga 6 masa shpërblim dëmi në vlerën 3.375.978 leke janë zbatuar plotësisht 5 masa, ndërkohë 1 masë është në proces zbatimi. Në total deri më datën 30.11.2018 janë arkëtuar 1.550.802 lekë.

Nga verifikimi rezultoi se nga vlera e rekomanduar nga KLSH prej.....**3.375.978 lekë**

- Deri më datën 30.11.2018 është arkëtuar **1.550.802 lekë**

Në mënyrë të detajuar masat shpërblim rikërkojmë si më poshtë:

1.1. Gjetje nga auditimi: Në vitin 2015, nga ish Komuna Paskuqan, janë paguar nga fondi i veçantë shpërblime për punë të mirë gjithsej **427,102 lekë për 11 punonjës me dëm ekonomik**, në kundërshtim me VKM nr. 849, datë 6.12.2012 “Për një ndryshim në VKM nr. 929, datë 17.11.2010 “Për krijimin dhe përdorimin e fondit të veçantë”, të ndryshuar pika 9 (*trajtuar më hollësisht në faqet 19-52 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

1.1.1. Rekomandimi: Bashkia Kamëz, të kërkojë në rrugë ligjore arkëtimin e vlerës **427,102 lekë** nga 11 persona përfitues sipas listës emërore në fq. 48 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Menjëherë

2. Gjetje nga auditimi: U konstatua se për vitin 2016 dhe 2017, nga Drejtoria e Tatim Taksave , janë aplikuar tarifa për taksat për biznesin e vogël (taksë pastrimi, taksë ndërtese, taksë gjelbërimi), më të ulta se sa janë miratuar në paketën fiskale me Vendime të Këshillit të Bashkisë me efekt **dëm ekonomik për vlerën 2,134,754 lekë**, nga të cilat:

- 440,000 lekë në vitin 2016 në 27 raste dhe -1.694.754 lekë në vitin 2017 (*trajtuar më hollësisht në faqet 125-142 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

2.1. Rekomandimi: Nga Bashkia Kamëz të kryhet kontabilizimi dhe të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit me qëllim kërkimin për shpërblimin e **dëmit me vlerën 2,134,754 lekë**.

Menjëherë

2.BASHKIA RROGOZHINË:

- Nga verifikimi rezulton se KLSH ka dërguar në Bashkinë Rrogozhinë rekomandimet e auditimit me shkresën e saj nr.1297/15 Prot, datë 11.05.2018, protokolluar në Bashkinë Rrogozhinë me shkresën Nr.2103 Prot, datë 15.05.2018, ndërsa nga Bashkia Rrogozhinë për zbatim e

rekomandimeve të KLSH është kthyer përgjigje me shkresën e saj nr.340 datë 01.08.2018, protokolluar në KLSH me shkresën nr.1297/37 datë 03.08.2018. Përgjigja e Bashkisë për zbatimin e rekomandimeve të KLSH është bërë brenda afatit ligjor të kthimit të përgjigjes.

- Nga verifikimi rezulton se përfundimet e auditimit i janë dërguar subjektit të audituar Bashkisë Rrogozhinë, me shkresën e Kryetarit të KLSH nr.1297/15, datë 01.05.2018 dhe duhet të raportonte në KLSH brenda 6 muajve ose brenda datës **01.11.2018** (referuar nenit 30, pika 2 e ligjit nr.154/2014 datë 27.11.2014 “Për funksionimin dhe organizimin e KLSH, për raportimin brenda 6 muajve nga marrja e njoftimit të RPA)

-Nga verifikimi rezulton se Bashkia Rrogozhinë ka hartuar planin e veprimit të zbatimit të rekomandimeve të dërguara nga KLSH me shkresën nr.776/14 datë 15.12. 2017, ndërkohë nuk ka raportuar në këshillin e njësisë (këshillin bashkiak), në kundërshtim me ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, Neni 50-Auditimi i jashtëm *ku përcaktohet se;* 5. *Për të gjitha raportet e auditimit të jashtëm, të kryera nga Kontrolli i Lartë i Shtetit apo auditues të tjerë ligjorë, kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore përgatit një plan veprimi për zbatimin e rekomandimeve të raportit të auditimit.*

A. MASA ORGANIZATIVE:

Nga KLSH i janë rekomanduar Bashkisë Rrogozhinë 16 masa organizative, janë zbatuar plotësisht 4 masa, nuk ka masë organizative të pa zbatuar, ndërkohë që janë në proces zbatimi 12 masa organizative për të cilat rikërkojmë zbatimin e masave si vijon:

1.4 - Gjetje nga auditimi: Drejtorja e Financës në Bashkinë Rrogozhinë, për vitin 2016-2017, nuk ka kërkuar në rrugë ligjore dhe administrative arkëtimin e debitorëve në shumën 47,897,308 lekë, nga të cilët debitor nga tatim taksat në shumën 25,719,216 lekë dhe gjoba e penalitete në shumën 22,178,092 lekë dhe në fund të viti 2017 nuk ka shlyer detyrimet kreditore në shumën 54,598,827 lekë, veprim në papajtueshmëri me nenin 12 germa g, të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar (*Trajtuar hollësisht në faqet 15-20, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

1.4.1 - Rekomandimi: Drejtorja e Financës në Bashkinë Rrogozhinë të marrë masa, të kërkojë në rrugë ligjore dhe administrative arkëtimin e debitorëve në vlerën **47,897,308 lekë**, nga të cilët debitor nga tatim taksat në shumën **25,719,216 lekë** dhe gjoba e penalitete në shumën **22,178,092lekë**.

1.4.2 - Rekomandimi: Drejtorja e Financës në Bashkinë Rrogozhinë të marrë masa, të bëjë shlyerjen e detyrimeve kreditore në vlerën **54,598,827 lekë**, brenda afateve ligjore.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

2.8 - Gjetje nga auditimi: Bashkia Rrogozhinë, nga **14 masa** organizative ka zbatuar **4 masa**, në proces **2 masa** dhe pa zbatuar **8 masa**. Nuk janë zbatuar masa nr. 1, për arkëtimin e shumës **5,370,986 lekë** dhe shumës **21,225,465 lekë** për subjektet debitorë; masa nr. 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8 dhe 9 për 22 subjekte të palicencuara në shumën 607,160lekë.

Nga **8 masa** shpërbllim dëmi **nuk ka zbatuar 8 masanë** shumën **5,660,962 lekë** dhe konkretisht: masa nr. 1 në shumën 1,247,850 lekë nga sportistë të pa federuar; masa nr. 2 në shumën 60,000 lekë nga OE “B■■■■ T■■■■” në shërbimin e internetit; masa nr. 3, në shumën 2,011,000 lekë nga OE “E■■■■ Shpk”; masa nr. 4, në shumën 74,461 lekë nga Shoqëria M■■■■ Shpk; masa nr. 5 në shumën 873,072 lekë nga B■■■■ N■■■■; masa nr. 6 në shumën 13,288 lekë nga “M■■■■ Shpk” në shumën 37,101 lekë; masa nr. 8 në shumën 1,343,790 lekë nga anëtarët e këshillit të bashkisë dhe nga **14 masa** disiplinore **nuk janë zbatuar 14 masa**, veprim në kundërshtim me nenin 15 shkronja (j) dhe nenin 30 pika 2, të ligjit nr. 154, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollin të Lartë të Shtetit” (*Trajtuar hollësisht në faqet 13-14, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

2.8.1 - Rekomandimi: Bashkia Rrogozhinë të marrë masa, të zbatojë rekomandimet e lëna nga KLSH-ja dhe të kërkojë në rrugë ligjore dhe administrative arkëtimin e vlerës 32,257,413 lekë.

3.10 - Gjetje nga auditimi: Në Bashkinë Rrogozhinë dhe Njësitë Administrative Lekaj, Gosë, Kryeviidh dhe Sinaballaj, në fund të vitit 2017 janë debitorë për taksa dhe tarifa vendore 314 subjekte në shumën **25,719,216** lekë dhe familjarët në vlerën 96,298,783 lekë (5462 familje për taksë toke në vlerën 74,825,500 lekë, 4535 familje për Taksë ndërtese në vlerën 10,595,534 lekë dhe 4640 familje për tarifa të vendore në vlerën 10,877,750 lekë). Sektori i Tatim Taksave për arkëtimin e debitorëve nuk ka ndjekur procedurat e nevojshme ligjore, veprim në kundërshtim me nenin 4, 26, 32, 34, të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, nenet 90, 91, të ligjit nr. 9920 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar dhe nenin 12 të Udhëzimit të Ministrisë Financave nr. 24, datë 02.09.2008, Kreu i XI-Mbledhja me forcë e detyrimeve (*Trajtuar hollësisht në faqet 88-93, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

3.10.1 - Rekomandimi: Sektori i Tatim Taksave në Bashkinë Rrogozhinë të marrë masa, për arkëtimin e detyrimeve tatimore dhe të bëhen njoftim vlerësimet tatimore, për 314 subjekte debitorë në shumën **25,719,216 lekë**, bazuar në nenin 70 pika 3 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në RSH”, i ndryshuar, duke ndjekur rrugët e mëposhtme sipas Aneksit 7 dhe 8 në drejtimet si më poshtë:

a. Tu dërgohen bankave urdhra bllokimi për llogaritë bankare, bazuar në nenin 90, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

b. Të dërgoj në Drejtorinë Rajonale të Transportit, kërkesa për vendosjen e barrës sigurorese (për mjetet) dhe në Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, bazuar në nenin 91, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

c. Për subjektet të cilët nuk paguajnë detyrimet tatimore në afat, të llogaritet kamat vonesa (gjobë në masën 0,06 % kamat vonesë të detyrimit në ditë por jo më tepër se 365 ditë), bazuar në nenin 114, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

3.10.2 - Rekomandimi: Sektori i Tatim Taksave në Bashkinë Rrogozhinë të marrë masa, të hartojë listën elektronike për abonentët familjare, si dhe të kërkojë arkëtimin e vlerës **96,298,783 lekë**, sipas të dhënave të Gjendjes Civile, duke dërguar njoftim vlerësimet abonentëve familjarë me Postë, për:

- Taksë toke, për 5462 familje me vlerë 74,825,500 lekë;
- Taksë ndërtese, për 4535 familje me vlerë 10,595,534 lekë;
- Tarifa vendore, për 4640 familje me vlerë 10,877,750 lekë;

4.13. Gjetje nga auditimi: Në auditimin e kryer mbi aktivitetin e Inspektoratit të Mbrojtjes Territorit Vendor (IMTV), u konstatua se për subjektet të cilët kanë ndërtuar pa leje janë mbajtur **25 vendime administrative** (me gjobë) në vlerën **2,250,000 lekë**, vlerë kjo e pa kontabilizuar në librat e llogarive të Bashkisë Rrogozhinë dhe pa ndjekur asnjë procedurë ligjore për arkëtimin e gjobave, veprime në kundërshtim me nenin 16, të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve”, i ndryshuar, nenet 9, 22 dhe 30, të ligjit nr. 10279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative”, VKM nr. 894, datë 04.11.2015 “Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga inspektorati ndërtimor e urbanistik kombëtar e ai vendor”, ligjin nr. 9228, datë 29/4/2004 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare” dhe VKM nr. 783, datë 22/11/2006 “Për përcaktimin e standardeve dhe rregullave kontabël”.

Po kështu Inspektoratit të Mbrojtjes Territorit Vendor (IMTV), nuk ka ndjekur procedurat dhe kërkuar në Gjykatë për rivendosjen në afat për vendimet me gjobë të vendosura gjatë viteve, bazuar në nenet 151 dhe 152, të “Kodit të Procedurës Civile në Republikën e Shqipërisë” dhe ligjin nr. 10279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative”, nenet 24, 30 dhe 43, ku edhe pse sipas këtij të fundit për vënien në ekzekutim të vendimeve për kundërvajtjet administrative organet e administratës përjashtohen nga detyrimi për parapagimin e tarifave gjyqësore, pasi këto përballohen nga kundërvajtësi (*Trajtuar hollësisht në faqet 93-98, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

4.13.1 - Rekomandimi: Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit Vendor (IMTV), në bashkëpunim me Sektorin e Financës dhe Sektorin Juridik në Bashkinë Rrogozhinë, të marrë masa për kontabilizim e gjobave dhe të kërkojë në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative për arkëtimin e gjobave nga 25 subjekte në vlerën **2,250,000 lekë**, për kryerje të punimeve pa leje ndërtimi. Po kështu të kërkojë në Gjykatë rivendosjen në afat për vendimet me gjobë të vendosura gjatë viteve, bazuar në nenet 151 dhe 152, të “Kodit të Procedurës Civile në Republikën e Shqipërisë”

Menjëherë

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI:

Bazuar në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” neni 15 germa (b) dhe (c) –Të drejtat e KLSH dhe mbështetur në nenet 98-102, të ligjit nr. 44/2015, datë 30.04.2015 “Kodi i procedurave administrative në Republikën e Shqipërisë”, nenet 21-33, të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” dhe pikën 93, të udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 ”Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, nga Titullari i Njësisë Publike, të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore (Padi Gjyqësore) duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjyqimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit. Nëpunësi zbatues të ndjekë procesin dhe të kryej regjistrimet e nevojshme kontabël përfundimtare, me qëllim shpërblimin e dëmit në vlerën **24,244,496 lekë**.

Nga verifikimi rezultoi se nga 35 masa me vlerë 26.244.496 lekë, nuk janë pranuar 23 rekomandime në vlerën prej 9,877,446 lekë, duke u pranuar 11 rekomandime në vlerën prej 14,367,050 lekë, nga e cila deri me datë 30.11.2018, janë arkëtuar 705,646 lekë.

Në mënyrë të detajuar masat shpërblim rikërkojmë si më poshtë:

1.1 - Gjetje nga auditimi: Bashkia Rrogozhinë, me urdhër shpenzim nr. 539, datë 06.07.2016, në shumën 214,800 lekë, nr. 683, datë 22.08.2016, në shumën 440,000 lekë, nr. 1033, datë 19.12.2016, në shumën 48,600 lekë, nr. 355, datë 18.04.2017, në shumën 534,600 lekë, nr. 407, datë 05.05.2017, në shumën 120,600 lekë, nr. 598, datë 28.06.2017, në shumën 288,000 lekë, nr. 435, datë 18.09.2017, në shumën 723,000 lekë, nr. 593, datë 04.10.2017, në shumën 97,250 lekë, nr. 467, datë 09.10.2017, në shumën 540,600 lekë, nr. 962, datë 09.10.2017, në shumën 419,568 lekë, nr. 1096, datë 20.11.2017, në shumën 59,200 lekë dhe nr. 1097, datë 20.11.2017 në shumën 48,800 lekë ka bërë akomodim të futbollistëve me procedurën e prokurimit me vlera të vogla, duke mos zbatuar kërkesat për shërbime në një largësi deri në 50 km jashtë qendrës së punës, trajtimi financiar i punonjësit përfshin vetëm shpenzimet e transportit, në rastin kur transporti nuk realizohet nga vetë institucioni, shuma **3,535,018 lekë përbën shkelje të disiplinës financiare me dëm ekonomik** për buxhetin e Bashkisë, veprim në kundërshtim me VKM nr. 329, datë 20.04.2016 Për disa ndryshime në VKM nr. 997, datë 10.12.2010 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit”, i ndryshuar (*Trajtuar hollësisht në faqet 43-48, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

1.1.1. Rekomandimi: Bashkia Rrogozhinë të marrë masa, duke ndjekur të gjitha procedurat administrative e ligjore për arkëtimin e shumës **214,800 lekë**, sipas Aneksit 6, bashkëlidhur Projekt Raportit të Auditimit.

1.1.2- Rekomandimi: Bashkia Rrogozhinë të marrë masa, duke ndjekur të gjitha procedurat administrative e ligjore për arkëtimin e shumës **440,000 lekë**, sipas Aneksit 7, bashkëlidhur Projekt Raportit të Auditimit.

1.1.3- Rekomandimi: Bashkia Rrogozhinë të marrë masa, duke ndjekur të gjitha procedurat administrative e ligjore për arkëtimin e shumës **48,600 lekë**, sipas Aneksit 8, bashkëlidhur Projekt Raportit të Auditimit.

1.1.4- Rekomandimi: Bashkia Rrogozhinë të marrë masa, duke ndjekur të gjitha procedurat administrative e ligjore për arkëtimin e shumës **534,600 lekë**, sipas Aneksit 9, bashkëlidhur Projekt Raportit të Auditimit.

1.1.5- Rekomandimi: Bashkia Rrogozhinë të marrë masa, duke ndjekur të gjitha procedurat administrative e ligjore për arkëtimin e shumës **120,600 lekë**, sipas Aneksit 10, bashkëlidhur Projekt Raportit të Auditimit.

1.1.6- Rekomandimi: Bashkia Rrogozhinë të marrë masa, duke ndjekur të gjitha procedurat administrative e ligjore për arkëtimin e shumës **288,000 lekë**, sipas Aneksit 11, bashkëlidhur Projekt Raportit të Auditimit.

1.1.7- Rekomandimi: Bashkia Rrogozhinë të marrë masa, duke ndjekur të gjitha procedurat administrative e ligjore për arkëtimin e shumës **723,000 lekë** sipas Aneksit 12, bashkëlidhur Projekt Raportit të Auditimit.

1.1.8- Rekomandimi: Bashkia Rrogozhinë të marrë masa, duke ndjekur të gjitha procedurat administrative e ligjore për arkëtimin e shumës **97,250 lekë**, sipas Aneksit 13, bashkëlidhur Projekt Raportit të Auditimit.

1.1.9- Rekomandimi: Bashkia Rrogozhinë të marrë masa, duke ndjekur të gjitha procedurat administrative e ligjore për arkëtimin e shumës **540,600 lekë**, sipas Aneksit 14, bashkëlidhur Projekt Raportit të Auditimit.

1.1.10- Rekomandimi: Bashkia Rrogozhinë të marrë masa, duke ndjekur të gjitha procedurat administrative e ligjore për arkëtimin e shumës **419,568 lekë**, sipas Aneksit 15, bashkëlidhur Projekt Raportit të Auditimit.

1.1.11- Rekomandimi: Bashkia Rrogozhinë të marrë masa, duke ndjekur të gjitha procedurat administrative e ligjore për arkëtimin e shumës **108,000 lekë**, sipas Aneksit 16, bashkëlidhur Projekt Raportit të Auditimit.

Menjëherë

2.2 - Gjetje nga auditimi: Bashkia Rrogozhinë, me urdhër shpenzim nr. 338, datë 09.05.2016, në shumën 85.208 lekë, ka hartuar preventivin për objektin: “Riparim, vendosje Pompe dhe 1 bolero 1000 litra pranë fushës së sportit “Egnatia”, duke mos ndërsa nuk ka dorëzuar rezervarin e ujit. Mos dorëzimi i rezervuarit të ujit 1000 litra me vlerë **16,810 lekë, përbën shkelje të disiplinës financiare me dëm ekonomik për buxhetin e bashkisë**, veprim në kundërshtim me VKM nr. 629, datë 15.07.2015 “Për miratimin e manualeve teknike te çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre”, me pikën 19, të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar (*Në mënyrë të detajuar në faqen 29-30, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

2.2.1- Rekomandimi: Bashkia Rrogozhinë të marrë masa, duke ndjekur të gjitha procedurat administrative e ligjore për riparim dhe vendosje Pompe dhe bolero uji 1000 litra pranë fushës së sportit “Egnatia”, duke mos zbatuar kërkesat për miratimin e manualeve teknike te çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre, për arkëtimin e shumës **16,810 lekë:**

- në vlerën 5,603 lekë, nga B. [REDAKTUAR] P. [REDAKTUAR], me detyrë kryetar i komisionit me vlera të vogla;
- në vlerën 5,603 lekë, A. [REDAKTUAR] K. [REDAKTUAR], me detyrë anëtar i komisionit me vlera të vogla;
- në vlerën 5,603 lekë, nga F. [REDAKTUAR] M. [REDAKTUAR], me detyrë anëtar i komisionit me vlera të vogla;

Menjëherë

3.3 - Gjetje nga auditimi: Bashkia Rrogozhinë, me urdhër shpenzim nr. 454, datë 07.06.2016, në shumën 745,620 lekë, ka bërë pastrim pusi me kompresor me thellësi 242 ml, ndërsa nuk mund të pastrohet gjithë thellësia e pusit pasi ajo është hapësirën, shuma **174,240 lekë përbën shkelje të disiplinës financiare me dëm ekonomik** për buxhetin e bashkisë, veprim në kundërshtim me nenin 12 pikën 3 germa a, të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, me pikën 41, të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar (*Trajtuar hollësisht në faqet 30, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

3.3.1- Rekomandimi: Bashkia Rrogozhinë të marrë masa, duke ndjekur të gjitha procedurat administrative e ligjore për pastrimin e gjithë hapësirë së pusit për arkëtimin e shumës **174,240 lekë**:

- në vlerën 43,560 lekë, nga Helidon Begaj, me detyrë Sekretarë i Përgjithshëm, në cilësinë e Kryetarit të Entit Prokurues;
- në vlerën 43,560 lekë, nga B. P., me detyrë kryetar i komisionit me vlera të vogla;
- në vlerën 43,560 lekë nga A. K., me detyrë anëtar i komisionit me vlera të vogla;
- në vlerën 43,560 lekë nga F. M. me detyrë anëtar i komisionit me vlera të vogla;

Menjëherë

4.4 - Gjetje nga auditimi: Bashkia Rrogozhinë, me urdhër shpenzim nr. 476, datë 17.06.2016, në shumën 107,746 lekë dhe nr. 477, datë 17.06.2016, në shumën 25,061 lekë, ka paguar punonjësit e policisë bashkiake për orë pune jashtë kohës normale të punës. Bashkia Rrogozhinë, nuk duhet të bënte pagesën për “orë pune mbi kohën normale të punës”, por duhet tu kishte dhënë punonjësve të policisë bashkiake pushimet në ditët e më pasme, shuma **132,802 lekë përbën shkelje të disiplinës financiare me dëm ekonomik** për buxhetin e bashkisë, veprim në kundërshtim me germën c, të VKM nr. 591, datë 23.07.2010 “Për disiplinimin e përdorimit të fondeve buxhetore”, i ndryshuar (*Trajtuar hollësisht në faqet 31, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

4.4.1- Rekomandimi: Bashkia Rrogozhinë të marrë masa, duke ndjekur të gjitha procedurat administrative e ligjore për arkëtimin e shumës **132,802 lekë**, sipas Aneksit 1, bashkëlidhur Projekt Raportit të Auditimit.

Menjëherë

5.5 - Gjetje nga auditimi: Bashkia Rrogozhinë, me urdhër shpenzim nr. 701, datë 18.07.2016, në shumën 91,800 lekë, ka blerë produkte ushqimore për pritje përcjellje, ndërsa Institucionet shtetërore apo vendore mund të kryej shpenzime për pritje dhe përcjellje, por duke hartuar program pritje për delegacioni, qëllimin i takimit të delegacionit, numri i pjesëmarrësve, kuota e shpenzimit sipas grupeve etj. Preventivi i shpenzimeve për pritje delegacioni miratohet nga titullari i institucionit, shuma **91,800 lekë përbënë shkelje të disiplinës financiare me dëm ekonomik** për buxhetin e Bashkisë, veprim në papajtueshmëri me pikën 42, të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, të ndryshuar dhe VKM nr. 243, datë 15.05.1995 “Për shpenzimet për pritjen, përcjelljen dhe trajtimin që u bëhet delegacioneve të huaja”, të ndryshuar (*Trajtuar hollësisht në faqet 33, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

5.5.1 - Rekomandimi: Bashkia Rrogozhinë të marrë masa, duke ndjekur të gjitha procedurat administrative e ligjore për arkëtimin nga 3 persona sa paguar padrejtësisht për pritje përcjellje nga fondet e buxhetit të Bashkisë në vlerën **91,800 lekë**, përkatësisht:

- në vlerën 30,600 lekë, nga H. B. me detyrë Sekretarë i Përgjithshëm;
- në vlerën 30,600 lekë, F. M. me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Financës;
- në vlerën 30,600 lekë, A. D. me detyrë sekretar protokolli.

Menjëherë

6.6 - Gjetje nga auditimi: Bashkia Rrogozhinë, me urdhër shpenzim nr. 140, datë 14.02.2017 në shumën 167,011 lekë dhe nr. 141, datë 14.02.2017 në shumën 14,491 lekë, për periudhën shtator 2016 shkurt 2017, ka paguar punonjësit e policisë bashkiake për orë pune jashtë kohës normale të punës. Bashkia Rrogozhinë, nuk duhet të bënte pagesën për “orë pune mbi kohën normale të punës”, por duhet tu kishte dhënë punonjësve të policisë bashkiake pushimet në ditët e më pasme, shuma **186,502 lekë përbën shkelje të disiplinës financiare me dëm ekonomik** për buxhetin e bashkisë, veprim në kundërshtim me germën c, të VKM nr. 591, datë 23.07.2010 “Për disiplinimin e përdorimit të fondeve buxhetore”, i ndryshuar (*Trajtuar hollësisht në faqet 34,-35 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

6.6.1- Rekomandimi: Bashkia Rrogozhinë të marrë masa, duke ndjekur të gjitha procedurat administrative e ligjore për arkëtimin e shumës **186,502 lekë**, sipas Aneksit 2, bashkëlidhur Projekt Raportit të Auditimit.

Menjëherë

7.7 - Gjetje nga auditimi: Bashkia Rrogozhinë, me urdhër shpenzim nr. 153, datë 07.03.2016, në shumën 68.800 lekë, ka bërë transportin e futbollistëve me procedurën e prokurimit me vlera të vogla, duke mos zbatuar tarifën e transportit të udhëtarëve, shuma **68,800 lekë përbën shkelje të disiplinës financiare me dëm ekonomik** për buxhetin e Bashkisë, veprim në kundërshtim me VKM nr. 66, datë 07.02.2007 “Për tarifën e transportit të udhëtarëve”, i ndryshuar (*Trajtuar hollësisht në faqet 42, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

7.7.1- Rekomandimi: Bashkia Rrogozhinë të marrë masa, duke ndjekur të gjitha procedurat administrative e ligjore për arkëtimin e shumës **68,800 lekë**, sipas Aneksit 3, bashkëlidhur Projekt Raportit të Auditimit.

Menjëherë

8.8 - Gjetje nga auditimi: Bashkia Rrogozhinë, me urdhër shpenzim nr. 160, datë 09.03.2016, në shumën 646,800 lekë, ka bërë akomodim të futbollistëve (ushqim + fjetje + transport), me procedurën e prokurimit me vlera të vogla duke mos zbatuar kërkesat për shërbime në një largësi deri në 50 km jashtë qendrës së punës, trajtimi financiar i punonjësit përfshin vetëm shpenzimet e transportit, në rastin kur transporti nuk realizohet nga vetë institucioni, shuma **646,800 lekë përbën shkelje të disiplinës financiare me dëm ekonomik** për buxhetin e Bashkisë, veprim në kundërshtim me VKM nr. 329, datë 20.04.2016 Për disa ndryshime në VKM nr. 997, datë 10.12.2010 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit”, i ndryshuar (*Trajtuar në faqet 42-43, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

8.8.1- Rekomandimi: Bashkia Rrogozhinë të marrë masa, duke ndjekur të gjitha procedurat administrative e ligjore për arkëtimin e shumës **646,800 lekë**, sipas Aneksit 4, bashkëlidhur Projekt Raportit të Auditimit.

Menjëherë

9.9 - Gjetje nga auditimi: Bashkia Rrogozhinë, me urdhër shpenzim nr. 472, datë 17.06.2016, në shumën 390.600 lekë, ka bërë transport të futbollistëve me procedurën e prokurimit me vlera të vogla, duke mos zbatuar tarifën e transportit të udhëtarëve, shuma **390,600 lekë përbën shkelje të disiplinës financiare me dëm ekonomik** për buxhetin e Bashkisë, veprim në kundërshtim me VKM nr. 66, datë 07.02.2007 “Për tarifën e transportit të udhëtarëve”, i ndryshuar (*Trajtuar hollësisht në faqet 43, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

9.9.1- Rekomandimi: Bashkia Rrogozhinë të marrë masa, duke ndjekur të gjitha procedurat administrative e ligjore për arkëtimin e shumës **390,600 lekë**, sipas Aneksit 5, bashkëlidhur Projekt Raportit të Auditimit.

Menjëherë

10.10 - Gjetje nga auditimi: Bashkia Rrogozhinë, për vitin 2016-2017 ka paguar R■■■■ B■■■, në listë pagesat e futbollistëve të klubit “Egnatia”, ndërsa R■■■■ B■■■ në të njëjtën kohë është paguar edhe në listë pagesat e Administratës së Bashkisë, pasi sipas strukturës organike është emëruar punëtorë i fushës sportit, **duke u paguar për të njëjtën punë dy herë, shuma 263,550 lekë** (109,700 lekë + 153,850 lekë), **që përbën shkelje të disiplinës financiare me dëm ekonomik** për buxhetin e Bashkisë, veprim në kundërshtim me nenin 4 pika 26, neni 12 pikën 3 germa **dh, e**, të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar (*Trajtuar hollësisht në faqet 48-49, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

10.10.1- Rekomandimi: Bashkia Rrogozhinë të marrë masa, duke ndjekur të gjitha procedurat administrative e ligjore për arkëtimin e shumës **263,550 lekë**, nga R■■■■ B■■■ punëtorë i fushës sportit.

Menjëherë

11.11 - Gjetje nga auditimi: Për vitin 2016 dhe muajin Janar 2017, D■■■■ P■■■■, me detyrë ish-shofer i administratës, ka tërhequr nga magazina karburant, bashkëlidhur nuk ndodhen fletë udhëtimet në lidhje me harxhimin e karburanti prej **4715 litra** me vlerë **772,962 lekë** (757,107 + 83,715), **që përbën shkelje të disiplinës financiare me dëm ekonomik** për buxhetin e Bashkisë, veprim në kundërshtim me pikën 36, të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve

në njësitë e sektorit publik”, të ndryshuar (*Trajtuar hollësisht në faqet 50, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

11.11.1- Rekomandimi: Bashkia Rrogzhinë të marrë masa, duke ndjekur të gjitha procedurat administrative e ligjore për arkëtimin e shumës **772,962 lekë**, në se nuk depoziton dokumentacionin vërtetues për shpenzimet, nga D [] P [], me detyrë ish-shofer i administratës sipas Aneksit 17, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Menjëherë

12.12 - Gjetje nga auditimi: Për vitin 2016 dhe muajin Janar 2017, R [] B [], me detyrë punëtor i fushës së futbollit, ka tërhequr nga magazina karburant, bashkëlidhur nuk ndodhet dokumentacioni në lidhje me harxhimin e karburanti prej **1400 litra** me vlerë **198,019 lekë** (757,107 + 83,715), **që përbën shkelje të disiplinës financiare me dëm ekonomik** për buxhetin e Bashkisë, veprim në kundërshtim me pikën 36, të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar (*Trajtuar hollësisht në faqet 50, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

12.12.1- Rekomandimi: Bashkia Rrogzhinë të marrë masa, duke ndjekur të gjitha procedurat administrative e ligjore për arkëtimin e shumës **198,019 lekë**, nga R [] B [] punëtorë i fushës sportit sipas Aneksit 18, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Menjëherë

13.13 - Gjetje nga auditimi: Për vitin 2016 – 2017, P [] H [], me detyrë përgjegjës i Klubit të futbollit “Egnatia”, ka tërhequr nga magazina karburant, bashkëlidhur nuk ndodhet dokumentacioni në lidhje me harxhimin e karburanti prej **2995 litra**, me vlerë **425,558 lekë** (181,396 + 244,162), **që përbën shkelje të disiplinës financiare me dëm ekonomik** për buxhetin e Bashkisë, veprim në kundërshtim me pikën 36, të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar (*Trajtuar hollësisht në faqet 50-51, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

13.13.1- Rekomandimi: Bashkia Rrogzhinë të marrë masa, duke ndjekur të gjitha procedurat administrative e ligjore për arkëtimin e shumës **425,558 lekë**, nga P [] H [], me detyrë përgjegjës i Klubit të futbollit “Egnatia”, sipas Aneksit 19, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Menjëherë

14.14 - Gjetje nga auditimi: Për vitin 2016 dhe janar 2017, F [] M [], me detyrë Përgjegjës i Financës, ka tërhequr nga magazina karburant, bashkëlidhur nuk ndodhet dokumentacioni në lidhje me harxhimin e karburanti prej **1510 litra** me vlerë **244,024 lekë** (20,540 + 33,486), **që përbën shkelje të disiplinës financiare me dëm ekonomik** për buxhetin e Bashkisë, veprim në kundërshtim me pikën 36, të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar (*Trajtuar hollësisht në faqet 51, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

14.14.1- Rekomandimi: Bashkia Rrogzhinë të marrë masa, duke ndjekur të gjitha procedurat administrative e ligjore për arkëtimin e shumës **244,024 lekë**, nga F [] M [], me detyrë Përgjegjës i Financës sipas Aneksit 20, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Menjëherë

15.15 - Gjetje nga auditimi: Për vitin 2016, S [] B [] me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Arsimit, Turizmit dhe Sporteve, ka tërhequr nga magazina karburant, bashkëlidhur nuk ndodhet dokumentacion në lidhje me harxhimin e karburanti prej **2777 litra** me vlerë **425,439 lekë**, **që përbën shkelje të disiplinës fi nanciare me dëm ekonomik** për buxhetin e Bashkisë, veprim në kundërshtim me pikën 36, të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar (*Trajtuar hollësisht në faqet 51, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

15.15.1- Rekomandimi: Bashkia Rrogzhinë të marrë masa, duke ndjekur të gjitha procedurat administrative e ligjore për arkëtimin e shumës **425,439 lekë**, nga S [] B [] me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Arsimit, Turizmit dhe Sporteve sipas Aneksit 21, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Menjëherë

16.16 - Gjetje nga auditimi: Për vitin 2016, M [REDACTED] D [REDACTED] me detyrë inspektor i tatim taksave, ka tërhequr nga magazina karburant, bashkëlidhur nuk ndodhet dokumentacioni në lidhje me harxhimin e karburanti prej **1344 litra** me vlerë **195,136 lekë, që përbën shkelje të disiplinës financiare me dëm ekonomik** për buxhetin e Bashkisë, veprim në kundërshtim me pikën 36, të UMF nr. 30, datë 27.12.2011“Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar (*Trajtuar hollësisht në faqet 51, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

16.16.1- Rekomandimi: Bashkia Rrogozhinë të marrë masa, duke ndjekur të gjitha procedurat administrative e ligjore për arkëtimin e shumës **195,136 lekë**, nga M [REDACTED] D [REDACTED] me detyrë inspektor i tatim taksave, sipas Aneksit 22, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Menjëherë

17.17 - Gjetje nga auditimi: Për vitin 2016-2017, A [REDACTED] T [REDACTED], me detyrë Kryeinspektor i Mbrojtjes së Territorit, ka tërhequr nga magazina karburant, bashkëlidhur nuk ndodhet dokumentacioni në lidhje me harxhimin e karburanti prej **6190 litra** me vlerë **964,448 lekë** (459,983 + 504,465), që **përbën shkelje të disiplinës financiare me dëm ekonomik** për buxhetin e Bashkisë, veprim në kundërshtim me pikën 36, të UMF nr. 30, datë 27.12.2011“Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar (*Trajtuar hollësisht në faqet 51-52, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

17.17.1- Rekomandimi: Bashkia Rrogozhinë të marrë masa, duke ndjekur të gjitha procedurat administrative e ligjore për arkëtimin e shumës **964,448 lekë**, nga A [REDACTED] T [REDACTED] me detyrë Kryeinspektor i Mbrojtjes së Territorit, sipas Aneksit 23, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Menjëherë

18.18 - Gjetje nga auditimi: Për vitin 2016, B [REDACTED] P [REDACTED] me detyrë Drejtor i Shërbimeve Mbështetëse, ka tërhequr nga magazina karburant, ndërsa bashkëlidhur nuk ndodhet dokumentacioni në lidhje me harxhimin e karburanti prej **1050 litra** me vlerë **150,614 lekë** (362,849 + 83,715), që **përbën shkelje të disiplinës financiare me dëm ekonomik** për buxhetin e Bashkisë,veprim në kundërshtim me pikën 36, të UMF nr. 30, datë 27.12.2011“Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar(*Trajtuar hollësisht në faqet 52, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

18.18.1- Rekomandimi: Bashkia Rrogozhinë të marrë masa, duke ndjekur të gjitha procedurat administrative e ligjore për arkëtimin e shumës **150,614 lekë**, nga B [REDACTED] P [REDACTED] me detyrë Drejtor i Shërbimeve Mbështetëse, sipas Aneksit 24 bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Menjëherë

19.19- Gjetje nga auditimi: Për vitin 2016, I [REDACTED] H [REDACTED] me detyrë juriste, ka tërhequr nga magazina karburant, bashkëlidhur nuk ndodhet dokumentacioni në lidhje me harxhimin e karburanti prej **350 litra** me vlerë **50,579 lekë, që përbën shkelje të disiplinës financiare me dëm ekonomik** për buxhetin e Bashkisë,veprim në kundërshtim me pikën 36, të UMF nr. 30, datë 27.12.2011“Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar(*Trajtuar hollësisht në faqet 52, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

19.19.1- Rekomandimi: Bashkia Rrogozhinë të marrë masa, duke ndjekur të gjitha procedurat administrative e ligjore për arkëtimin e shumës **50,579 lekë**, nga I [REDACTED] H [REDACTED] me detyrë juriste sipas Aneksit 25, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Menjëherë

20.20- Gjetje nga auditimi: Për vitin 2016 dhe janar 2017, H [REDACTED] P [REDACTED] Përgjegjës i Sektorit juridik, ka tërhequr nga magazina karburant, bashkëlidhur nuk ndodhet dokumentacioni në lidhje me harxhimin e karburanti prej **790 litra** me vlerë **120,563 lekë, që përbën shkelje të disiplinës financiare me dëm ekonomik** për buxhetin e Bashkisë,veprim në kundërshtim me pikën 36, të UMF nr. 30, datë 27.12.2011“Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar(*Trajtuar hollësisht në faqet 52, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

20.20.1- Rekomandimi: Bashkia Rrogozhinë të marrë masa, duke ndjekur të gjitha procedurat administrative e ligjore për arkëtimin e shumës **120,563 lekë**, nga H [] P [] Përgjegjës i Sektorit juridik, sipas Aneksit 26, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Menjëherë

21.21- Gjetje nga auditimi: Për vitin 2016 dhe janar 2017, Z [] K [] me detyrë Kryeinspektor i Mbrojtjes së Territorit, për vitin 2016, ka tërhequr nga magazina karburant, bashkëlidhur nuk ndodhet dokumentacioni në lidhje me harxhimin e karburanti prej **1650 litra** me vlerë **239,425 lekë, që përbën shkelje të disiplinës financiare me dëm ekonomik** për buxhetin e Bashkisë, veprim në kundërshtim me pikën 36, të UMF nr. 30, datë 27.12.2011“Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar(*Trajtuar hollësisht në faqet 52, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

21.21.1- Rekomandimi: Bashkia Rrogozhinë të marrë masa, duke ndjekur të gjitha procedurat administrative e ligjore për arkëtimin e shumës **239,425 lekë**, nga Z [] K [] me detyrë Kryeinspektor i Mbrojtjes së Territorit, sipas Aneksit 27 bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Menjëherë

22.22- Gjetje nga auditimi: Për vitin 2017, E [] N [] me detyrë Kryeinspektor i Mbrojtjes së Territorit, ka tërhequr nga magazina karburant, bashkëlidhur nuk ndodhet dokumentacioni në lidhje me harxhimin e karburanti prej **1490 litra** me vlerë **236,317 lekë, që përbën shkelje të disiplinës financiare me dëm ekonomik** për buxhetin e Bashkisë,veprim në kundërshtim me pikën 36, të UMF nr. 30, datë 27.12.2011“Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar(*Trajtuar hollësisht në faqet 53, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

22.22.1- Rekomandimi: Bashkia Rrogozhinë të marrë masa, duke ndjekur të gjitha procedurat administrative e ligjore për arkëtimin e shumës **236,317 lekë**, nga E [] N [] me detyrë Kryeinspektor i Mbrojtjes së Territorit sipas Aneksit 28, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Menjëherë

23.23- Gjetje nga auditimi: Për vitin 2017, A [] C [], Inspektor sporti, ka tërhequr nga magazina karburant, bashkëlidhur nuk ndodhet dokumentacioni në lidhje me harxhimin e karburanti prej **2070 litra** me vlerë **331,856 lekë, që përbën shkelje të disiplinës financiare me dëm ekonomik** për buxhetin e Bashkisë, veprim në kundërshtim me pikën 36, të UMF nr. 30, datë 27.12.2011“Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar(*Trajtuar hollësisht në faqet 53, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

23.23.1- Rekomandimi: Bashkia Rrogozhinë të marrë masa, duke ndjekur të gjitha procedurat administrative e ligjore për arkëtimin e shumës **331,856 lekë**, nga A [] C [] me detyrë Inspektor sporti, sipas Aneksit 29, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Menjëherë

24.24 Gjetje nga auditimi: Për vitin 2017, A [] K [], me detyrë shofer i administratës, ka tërhequr nga magazina karburant, bashkëlidhur nuk ndodhet dokumentacioni në lidhje me harxhimin e karburanti prej **500 litra** me vlerë **81,900 lekë, që përbën shkelje të disiplinës financiare me dëm ekonomik** për buxhetin e Bashkisë,veprim në kundërshtim me pikën 36, të UMF nr. 30, datë 27.12.2011“Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar(*Trajtuar hollësisht në faqet 53, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

24.24.1- Rekomandimi: Bashkia Rrogozhinë të marrë masa, duke ndjekur të gjitha procedurat administrative e ligjore për arkëtimin e shumës **81,900 lekë**, nga A [] K [] me detyrë shofer i administratës, sipas Aneksit 30, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Menjëherë

25.25 - Gjetje nga auditimi: Për vitin 2017, A [] T [], me detyrë shofer i administratës, ka tërhequr nga magazina karburant, bashkëlidhur nuk ndodhet dokumentacioni në lidhje me harxhimin e karburanti prej **812 litra** me vlerë **121,264 lekë, që përbën shkelje të disiplinës financiare me dëm ekonomik** për buxhetin e Bashkisë, veprim në kundërshtim me pikën 36, të

UMF nr. 30, datë 27.12.2011“Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar(*Trajtuar hollësisht në faqet 53, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

25.25.1- Rekomandimi: Bashkia Rrogozhinë të marrë masa, duke ndjekur të gjitha procedurat administrative e ligjore për arkëtimin e shumës **176,221 lekë**, nga A [] T [] me detyrë shofer i administratës, sipas Aneksit 31, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Menjëherë

26.26- Gjetje nga auditimi: Për vitin 2017, E [] D [] ka tërhequr nga magazinës karburant, bashkëlidhur nuk ndodhet dokumentacioni në lidhje me harxhimin e karburanti prej **630 litra** me vlerë **94,084 lekë**, që përbën shkelje të disiplinës financiare me dëm ekonomik për buxhetin e Bashkisë,veprim në kundërshtim me pikën 36, të UMF nr. 30, datë 27.12.2011“Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar(*Trajtuar hollësisht në faqet 53, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

26.26.1- Rekomandimi: Bashkia Rrogozhinë të marrë masa, duke ndjekur të gjitha procedurat administrative e ligjore për arkëtimin e shumës **212,063 lekë**, nga E [] D [] sipas Aneksit 32, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Menjëherë

27.27- Gjetje nga auditimi: Sektori i Financës në Bashkinë Rrogozhinë, për objektin e marrë me qira nga subjekti privat “T [] G []” shpk nuk ka llogaritur 20% tvsh me vlerë **17,781 lekë**, si dhe nuk ka llogaritur **tatim në burim në shumën 18,364 lekë** (88,320 lekë x 15%). Shuma **31,612 lekë** (17,781 lekë + 18,364 lekë), përbën shkelje të disiplinës financiare me dëm ekonomik për buxhetin e Bashkisë, veprim në kundërshtim me nenin 12, të ligjit nr. 10 296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar dhe pika 31 germa d, të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësinë e sektorit publik”, i ndryshuar(*Trajtuar hollësisht në faqet 56, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

27.27.1- Rekomandimi: Bashkia Rrogozhinë të marrë masa, duke ndjekur të gjitha procedurat administrative e ligjore për arkëtimin e shumës **31,612 lekë lekë**, ngas subjekti privat “T [] G []” shpk.

Menjëherë

28.28- Gjetje nga auditimi: Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse e më pas Sektori i Pyjeve dhe Mbrojtjes Mjedisit, nuk ka bërë të mundur arkëtimin e detyrimeve që rrjedhin për 11 kontrata, sipas Aneksit 41,për shfrytëzim të fondit pyjorë dhe kullësorë, për sipërfaqen 10.955 ha, për periudhën viti 2014- 2017, në shumën 3,723,940 lekë, e cila është llogaritur sipas VKM nr. 391, datë 21.06.2006 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të Kullotave”, të ndryshuar dhe kamat vonesa të llogaritura në vlerën 320,962 lekë, gjithsej **4,044,902 lekë** e cila përbën shkelje të disiplinës financiare me dëm në buxhetin e Bashkisë, veprim në papajtueshmëri me nenin 12,ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiarë dhe Kontrollin” dhe kushtet e kontratave (*Trajtuar hollësisht në faqet 102-105, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

28.28.1 - Rekomandimi: Bashkia Rrogozhinë të marrë masa, duke ndjekur të gjitha procedurat administrative e ligjore për të kërkuar zbatimin e kontratave dhe arkëtimin e vlerës **4,044,902 lekë**, nga 11 subjektet, sipas **Aneksit 41**, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Menjëherë

29.29- Gjetje nga auditimi: Nga Bashkia Rrogozhinë janë lidhur kontrata për dhënie me qira të hapësirës së plazhit të ndodhur në plazhin e Spilles, u konstatua se 3 subjekte, për sipërfaqen **6020 m²** nuk kanë shlyer detyrimet e kontratës për vitin 2017, në vlerën 1,204,000 lekë dhe kamat vonesa të llogaritura në vlerën 24,722 lekë, gjithsej **1,228,722 lekë** e cila përbën shkelje të disiplinës financiare me dëm në buxhetin e Bashkisë, veprim në papajtueshmëri me kushtet e kontratave dhe nenin 12,ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiarë dhe Kontrollin” (*Trajtuar hollësisht në faqet 88-93, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

29.29.1 - Rekomandimi:Bashkia Rrogozhinë të marrë masa, duke ndjekur të gjitha procedurat administrative e ligjore për të kërkuar zbatimin e kontratave dhe arkëtimin e vlerës **1,228,722 lekë**, nga 3 subjektet, sipas **Aneksit 36**, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Menjëherë

30.30- Gjetje nga auditimi: Nga Bashkia Rrogozhinë gjatë vitit 2013, janë lidhur kontrata për dhënie me qira e tokave bujqësore të pandara, të një sipërfaqe prej 27.6 ha, u konstatua se 7 fermer, nuk kanë shlyer detyrimet e kontratës, në vlerën 188,040 lekë dhe kamat vonesat në vlerën 15,177 lekë, **gjithsej 203,217 lekë** e cila përbën shkelje të disiplinës financiare **me dëm në buxhetin e Bashkisë**, veprim në papajtueshmëri me kushtet e kontratave dhe nenin 12, ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiarë dhe Kontrollin” (Trajtuar hollësisht në faqet 88-93, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

30.30.1 - Rekomandimi: Bashkia Rrogozhinë të marrë masa, duke ndjekur të gjitha procedurat administrative e ligjore për të kërkuar zbatimin e kontratave dhe arkëtimin e vlerës **203,217 lekë**, nga 7 fermerë, sipas **Aneksit 37**, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Menjëherë

31.31. Gjetje nga auditimi: Në objektin “Rivitalizimi Urban i Qendrës së Qytetit”, Rrogozhinë, nga auditimi i dokumentacionit teknik të projekt- preventivit të hartuar nga projektuesi, dokumentacionit të dosjes së zbatimit, mbikëqyrjes dhe kolauditimit të punimeve të ndërtimit të administruara në dosjen teknike rezultuan diferenca në volume pune të likuiduara por jo të kryera në fakt në përputhje me projekt – preventivin dhe specifikimet teknike të miratuara nga AK në vlerën **7,007,906 pa t.v.sh.** Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 2417 prot., datë 26.09.2016 të lidhur mes Titullarit të Autoritetit Kontraktor Bashkia Rrogozhinë dhe OE “C [REDAKTUAR] R [REDAKTUAR] 2 [REDAKTUAR]” sh.p.k si dhe me Vendimin Nr. 514, datë 15.08.2007 “Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, e konkretisht pika 2, 3 dhe 9 (Trajtuar hollësisht në faqet 74-87, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

31.31.1. Rekomandimi: Nga Bashkia Rrogozhinë të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **7,007,906 pa t.v.sh** nga operatori ekonomik “C [REDAKTUAR] R [REDAKTUAR] 2 [REDAKTUAR]” sh.p.k, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën nr. 2417 prot., datë 26.09.2016 me objekt “Rivitalizimi Urban i Qendrës së Qytetit”, Rrogozhinë, vlerë kjo e cila përfaqëson një dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore si rrjedhojë e likuidimit të punimeve të kryera jo në përputhje me projekt – preventivin dhe specifikimet teknike të miratuara nga AK dhe prej mos ndryshimit të zërave në situacion sipas zërit faktit.

Menjëherë

32.32. Gjetje nga auditimi: Në objektin “Rikonstruksioni i rrugëve të brendshme të Bashkisë Rrogozhinë faza 2-3”, nga auditimi i dokumentacionit teknik të projekt – preventivit të hartuar nga projektues rezultoi një rritje fiktive e fondit limit në vlerën 916,940 lekë pa tvsh nga të cilat vlera **705,646 lekë pa tvsh** me pasojë dëm ekonomik. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Vendimin Nr. 514, datë 15.08.2007 “Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, e konkretisht pika 2, 3 dhe 9 (Trajtuar hollësisht në faqet 74-87, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

32.32.1. Rekomandimi: Nga Bashkia Rrogozhinë të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **705,646 lekë** nga ing. A [REDAKTUAR] T [REDAKTUAR], në cilësinë e hartuesit të projekt – preventivit të punimeve në investimit me objekt “Rikonstruksioni i rrugëve të brendshme të Bashkisë Rrogozhinë faza 2-3”, vlerë kjo e cila përfaqëson një dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore si rrjedhojë e rritjes fiktive të fondit limit të vënë në dispozicion të investimit.

Menjëherë

D. MASA ADMINISTRATIVE;

1. Mbi gjokat e rekomanduara IMTV.

Referuar shkeljeve të konstatuara në fushën e ndërtimit, përcaktuar në nenin 7 dhe 12 i ndryshuar, Kreu III, nenin 15 e 16 të ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar dhe Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolauditimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, Kreu II, Pika 3 (si dhe përgjegjësitë individuale të evidentuar dhe pasqyruar në pjesët takuese të Raportit Përfundimtar të Auditimit dhe komentet e subjektit të audituar, mbështetur në nenin 5 shkronja (b) dhe nenin 9/1, shkronja (a) të ligjit nr.

9780, datë 16.07.2007, ndryshuar me nenin 12 të ligjit nr.183/2014 datë 01.04.2013 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, bazuar në nenin 15 dhe nenin 30, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, **KLSH i rekomandon** Kryetarit të Bashkisë Rrogzhinë t’i **rikërkojë** Kryeinspektorit të Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor, të vlerësojë shkeljet e konstatuara dhe **të vendosë masë administrative me gjobë për 2 mbikëqyrës** punimesh si më poshtë:

1-L [REDAKTUAR] **T** [REDAKTUAR], në masën **50,000 lekë** për shkeljet e konstatuara nën cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve në objekt.

2-A [REDAKTUAR] **N** [REDAKTUAR], në masën **50,000 lekë** për shkeljet e konstatuara nën cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve.

Menjëherë

3.BASHKIA PRRENJAS

- Nga verifikimi rezulton se KLSH ka dërguar në Bashkinë Prrenjas rekomandimet e auditimit me shkresën e saj nr.1299/15 Prot, datë 07.05.2018, protokolluar në Bashkinë Prrenjas me shkresën nr.1123/1 Prot, datë 10.05.2018, ndërsa nga Bashkia Prrenjas për zbatim e rekomandimeve të KLSH është kthyer përgjigje me shkresën e saj nr.1123/3 Prot., datë 29.05.2018, protokolluar në KLSH me shkresën nr.1299/16 Prot., datë 01.06.2018. Përgjigja e Bashkisë për zbatimin e rekomandimeve të KLSH është bërë brenda **afatit ligjor të kthimit të përgjigjes**.

- Nga verifikimi rezulton se përfundimet e auditimit i janë dërguar subjektit të audituar Bashkisë Prrenjas, me shkresën e Kryetarit të KLSH nr.1299/15 Prot., datë 07.05.2018 dhe duhet të raportonte në KLSH brenda 6 muajve ose brenda datës **15.06.2018** (referuar nenit 30, pika 2 e ligjit nr.154/2014 datë 27.11.2014 “Për funksionimin dhe organizimin e KLSH, për raportimin brenda 6 muajve nga marrja e njoftimit të RPA)

- Nga verifikimi rezulton se Bashkia Prrenjas ka hartuar planin e veprimit të zbatimit të rekomandimeve të dërguara nga KLSH me shkresën nr.776/14 Prot datë 15.12. 2017, **ndërkohë ka raportuar në këshillin e njësisë** (këshillin bashkiak), ku ka paraqitur “Relacion për Këshillin Bashkiak”, protokolluar me shkresën nr.2961 prot., datë24.10.2018 dhe shkresën nr. 2961/2prot., datë 15.11.2018” informacion për zbatimin e rekomandimeve, siç parashikohet në ligjin nr.68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, Neni 50-Auditimi i jashtëm pika 5, ku përcaktohet se; pika 5. Për të gjitha raportet e auditimit të jashtëm, të kryera nga Kontrolli i Lartë i Shtetit apo auditues të tjerë ligjorë, kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore përgatit një plan veprimi për zbatimin e rekomandimeve të raportit të auditimit.

A. MASA ORGANIZATIVE:

Nga KLSH i janë rekomanduar Bashkisë Prrenjas 12 masa organizative, të cilat janë pranuar dhe prej tyre, janë zbatuar plotësisht 6 masa, nuk ka masë organizative të pazbatuar, ndërkohë që janë në proces zbatimi 6 masa për të cilat rikërkojmë zbatimin e masave si vijon:

1.6. Gjetje nga auditimi: Për vitin 2017, të ardhurat nga taksat e tarifave vendore nga 54,000 mijë lekë të parashikuara janë realizuar në vlerën 51,087 mijë lekë ose 94.6%, me një mosrealizim në vlerën 2,913 mijë lekë. Nga auditimi i treguesve të raportuar konstatohet se disa taksat e tarifave në krahasim me planin kanë tejkalime të ndjeshme, kjo tregon që planifikimi i të ardhurave të bashkisë për periudhën objekt auditimi nuk është bërë i studiuar, ka pasur rezerva për rritjen e planit të këtyre taksave e tarifave dhe për disa nga taksat e tarifave vendore nuk është patur parasysh realizimi i një viti më përpara (*trajtuar më hollësisht në faqet 80 - 90 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

1.6.1 Rekomandimi: Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës të marrin masa për vlerësimin sa më real të burimeve dhe veçanërisht bazën e tyre me qëllim që të mos evidentohen gjatë vitit ushtrimor tejkalime në disa zëra dhe mos realizime në disa të tjera me një marzh material në vendimmarrje në raport me mbledhjen e të ardhurave nga taksat dhe tarifave vendore.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

2.10. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit teknik për zbatimin e punimeve të kontratës me objekt “Rikonstruksion i rrugëve rurale Rrajcë, Kotodesh dhe Qukës Qendër” Prrenjas, të lidhurndërmjet Autoritetit Kontraktor Bashkisë Prrenjas dhe shoqërisë “B [REDAKTUAR] SHPK, u konstatua se raportet e testimi për betonin e ngurtësuar nuk përfaqësonin objektin e kësaj kontrate si dhe datat e hedhjes së betonit rezultuan të ishin, para datës së fillimit të punimeve në objekt. Testi i betonit të ngurtësuar është kryer për objektin rikonstruksion i rrugës “Stadiumi i vjetër-Stadiumi i ri, rruga stadiumit, rruga “Koli Vesho” dhe sheshi para stadiumit Berat” dhe jo për objektin, siç përcaktohet në kontratë (trajtuar më hollësisht në faqet 50 - 79 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2.10.1 Rekomandimi.Të merren masa nga Bashkia Prrenjas, që shoqëria “B [REDAKTUAR] SHPK të qartësojë dhe të vetëtojë cilësinë e betoneve të parashikuara në projektin e zbatimit sipas standardeve në fuqi.

Menjëherë

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI:

Bazuar në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” neni 15 germa (b) dhe (c) –*Të drejtat e KLSH* dhe mbështetur në nenet 98-102, të ligjit nr. 44/2015, datë 30.04.2015 “Kodi i procedurave administrative në Republikën e Shqipërisë”, nenet 21-33, të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” dhe pikën 93, të udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, nga Titullari i njësisë, të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore (Padi Gjyqësore) duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjyqimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit. **Nëpunësi zbatues** të ndjekë procesin me qëllim shpërblimin e dëmit në **vlerën 11,933,516 lekë**, si më poshtë:

Nga verifikimi rezultoi se nga vlera e rekomanduar nga KLSH prej.....**11.933,516 lekë**

-Deri më datën 14/11/2018 është arkëtuar.....206,800 lekë

Kanë mbetur pa u arkëtuar vlera prej 11,726,716 lekë

Nga të cilat:

-Nuk pranohen nga Subjekti vlera e rekomanduar për tu zhdëmtuar nga KVO.....2,724,053 lekë

-Në proces gjyqësor..... 7,621,770 lekë

-Janë nisur njoftime por ende nuk ka filluar arkëtimi i shumës.....1,380,893 lekë

Në mënyrë të detajuar masat shpërblim rikërkojmë si më poshtë:

1.3. Gjetje nga auditimi:Në objektin “Rikualifikimi Urban i rrugës nacionale në qytetin e Prrenjasit”, nga auditimi i dokumentacionit teknik të zbatimit, mbikëqyrjes dhe kolaudimit të punimeve të ndërtimit të administruara në dosjen teknike rezultuan diferenca në volume pune të likuiduara por të pakryera në fakt në vlerën **2,214,523 lekë pa tvsh**. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 2052 prot., datë 25.04.2017 të lidhur mes Titullarit të Autoritetit Kontraktor Bashkia Prrenjas dhe OE “Z [REDAKTUAR]” SHPK. (trajtuar më hollësisht në faqet 50 - 79 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.3.1. Rekomandimi.Nga Bashkia Prrenjas të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **2,214,523 lekë pa tvsh** nga operatori ekonomik “Z [REDAKTUAR]” sh.p.k, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën nr. 2052 prot., datë 25.04.2017 me objekt “Rikualifikimi Urban i rrugës nacionale në qytetin e Prrenjasit”, vlerë kjo e cila përfaqëson një dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë

vendore si rrjedhojë e likuidimit të punimeve të pakryera në fakt apo prej mos ndryshimit të zërave në situacion sipas zërit faktit.

Menjëherë pas përfundimit të procesit gjyqësor

2.4. Gjetje nga auditimi:Në objektin “Rikonstruksion rrugësh për Nj. A Qukës”, Prrenjas, nga auditimi i dokumentacionit teknik të zbatimit, mbikëqyrjes dhe kolaudimit të punimeve të ndërtimit të administruara në dosjen teknike rezultuan diferenca në volume pune të likuiduara por të pakryera në fakt në vlerën **96,348 lekë pa tvsh**. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 2129 prot., datë 09.06.2017 të lidhur mes Titullarit të Autoritetit Kontraktor Bashkia Prrenjas dhe OE “H [REDACTED]” sh.p.k. (trajtuar më hollësisht në faqet 50 - 79 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2.4.1. Rekomandimi:Nga Bashkia Prrenjas të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **96,348 lekë pa t.v.sh** nga operatori ekonomik “H [REDACTED]” sh.p.k, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën nr. 2129 prot., datë 09.06.2017 me objekt “Rikonstruksion rrugësh për Nj. A Qukës”, Prrenjas, vlerë kjo e cila përfaqëson një dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore si rrjedhojë e likuidimit të punimeve të pakryera në fakt.

Menjëherë pas përfundimit të procesit gjyqësor

3.5. Gjetje nga auditimi: Në objektin “Rikonceptimi i qendrës së qytetit dhe rikonstruksioni i fasadave qytetit, Prrenjasit”, nga auditimi i dokumentacionit teknik të zbatimit, mbikëqyrjes dhe kolaudimit të punimeve të ndërtimit të administruara në dosjen teknike rezultuan diferenca në volume pune të likuiduara por të pakryera në fakt në vlerën **437,280 lekë pa tvsh**. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 1994/4 prot., datë 30.06.2017, të lidhur mes Titullarit të Autoritetit Kontraktor Bashkia Prrenjas dhe OE “Z [REDACTED]” sh.p.k. (trajtuar më hollësisht në faqet 50 - 79 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

3.5.1. Rekomandimi:Nga Bashkia Prrenjas të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **437,280 lekë pa tvsh** nga operatori ekonomik “Z [REDACTED]” sh.p.k, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën nr. 1994/4 prot., datë 30.06.2017 me objekt “Rikonceptimi i qendrës së qytetit dhe rikonstruksioni i fasadave qytetit, Prrenjasit”, vlerë kjo e cila përfaqëson një dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore si rrjedhojë e likuidimit të punimeve të pakryera në fakt apo prej mos ndryshimit të zërave në situacion sipas zërit faktit.

Menjëherë pas përfundimit të procesit gjyqësor

4.6. Gjetje nga auditimi: Në objektin “Rikonstruksion i ujësjellësit Kotodesh”, Prrenjas, nga auditimi i dokumentacionit teknik të zbatimit, mbikëqyrjes dhe kolaudimit të punimeve të ndërtimit të administruara në dosjen teknike rezultuan diferenca në volume pune të likuiduara por të pakryera në fakt në vlerën **1,607,522 lekë pa tvsh**. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 2297/4 prot., datë 21.06.2017 të lidhur mes Titullarit të Autoritetit Kontraktor Bashkia Prrenjas dhe BOE “F [REDACTED]” sh.p.k dhe “L [REDACTED]” sh.p.k. (trajtuar më hollësisht në faqet 50 - 79 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

4.6.1. Rekomandimi:Nga Bashkia Prrenjas të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **1,607,522 lekë pa t.v.sh** nga BOE “F [REDACTED]” sh.p.k dhe “L [REDACTED]” sh.p.k, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën nr. 2297/4 prot., datë 21.06.2017 me objekt “Rikonstruksion i ujësjellësit Kotodesh”, Prrenjas, vlerë kjo e cila përfaqëson një dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore si rrjedhojë e likuidimit të punimeve të pakryera në fakt.

Menjëherë pas përfundimit të procesit gjyqësor

4.7. Gjetje nga auditimi:Në objektin “Rehabilitimi i kanalit vaditës Bratile - Stravaj Fshat”, Prrenjas, nga auditimi i dokumentacionit teknik të zbatimit, mbikëqyrjes dhe kolaudimit të punimeve të ndërtimit të administruara në dosjen teknike rezultuan diferenca në volume pune të likuiduara por të pakryera në fakt në vlerën **150,860 lekë pa tvsh**. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 291 prot., datë 03.02.2017 të lidhur mes Titullarit të Autoritetit Kontraktor Bashkia Prrenjas dhe OE “H [REDACTED]” sh.p.k. (trajtuar më hollësisht në faqet 50 - 79 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

4.7.1. Rekomandimi: Nga Bashkia Prrrenjas të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **150,860 lekë pa t.v.sh** nga operatori ekonomik “H [REDACTED]” sh.p.k, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën nr. 291 prot., datë 03.02.2017 me objekt “Rehabilitimi i kanalit vaditës Bratile - Stravaj Fshat”, Prrrenjas, vlerë kjo e cila përfaqëson një dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore si rrjedhojë e likuidimit të punimeve të pakryera në fakt.

Menjëherë pas përfundimit të procesit gjyqësor

5.8. Gjetje nga auditimi: Në objektin “Ndërtimi i linjës së ujësjellësit nga Burimi i Ujit në Galerinë 1070 deri në Depo uji Varovë Skroskë”, Prrrenjas, nga auditimi i dokumentacionit teknik të zbatimit dhe mbikëqyrjes së punimeve të ndërtimit të administruara në dosjen teknike rezultuan diferenca në volume pune të likuiduara por të pakryera në fakt në vlerën **263,579 lekë pa tvsh** si dhe mos aplikim i penalitetit për vonesa në përfundimin e punimeve në vlerën **1,153,157 lekë**. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 2932/3 prot., datë 01.02.2017 të lidhur mes Titullarit të Autoritetit Kontraktor Bashkia Prrrenjas dhe OE “R [REDACTED]” sh.p.k. (trajtuar më hollësisht në faqet 50 - 79 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

5.8.1. Rekomandimi: Nga Bashkia Prrrenjas të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **263,579 lekë pa t.v.sh** nga operatori ekonomik “R [REDACTED]” sh.p.k, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën nr. 2932/3 prot., datë 01.02.2017 me objekt “Ndërtimi i linjës së ujësjellësit nga Burimi i Ujit në Galerinë 1070 deri në Depo uji Varovë Skroskë”, Prrrenjas, vlerë kjo e cila përfaqëson një dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore si rrjedhojë e likuidimit të punimeve të pakryera në fakt apo prej mos ndryshimit të zërave në situacion sipas zërit faktit.

5.8.2. Rekomandimi: Nga Bashkia Prrrenjas të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **1,153,157 lekë** nga operatori ekonomik “R [REDACTED]” sh.p.k, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën nr. 2932/3 prot., datë 01.02.2017 me objekt “Ndërtimi i linjës së ujësjellësit nga Burimi i Ujit në Galerinë 1070 deri në Depo uji Varovë Skroskë”, Prrrenjas, vlerë kjo e cila përfaqëson penalitetin e pa aplikuar nga ana e Autoritetit Kontraktor Bashkia Prrrenjas ndaj sipërmarrësit të punimeve për vonesa të pa justifikuar në përfundimin në afat të punimeve.

Menjëherë pas përfundimit të procesit gjyqësor

6.9. Gjetje nga auditimi: Në objektin “Rikonstruksion i ujësjellësit Velçan – Urak njësia Administrative Rrajcë”, Prrrenjas, nga auditimi i dokumentacionit teknik të zbatimit dhe mbikëqyrjes së punimeve të ndërtimit të administruara në dosjen teknike rezultuan diferenca në volume pune të likuiduara por të pakryera në fakt në vlerën **62,650 lekë pa t.v.sh** si dhe mos aplikim i penalitetit për vonesa në përfundimin e punimeve në vlerën **263,851 lekë**. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 2254/4 prot., datë 19.06.2017 të lidhur mes Titullarit të Autoritetit Kontraktor Bashkia Prrrenjas dhe OE “R [REDACTED]” sh.p.k. (trajtuar më hollësisht në faqet 50 - 79 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

6.9.1. Rekomandimi: Nga Bashkia Prrrenjas të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **62,650 lekë pa tvsh** nga operatori ekonomik “R [REDACTED]” sh.p.k, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën nr. 2254/4 prot., datë 19.06.2017 me objekt “Rikonstruksion i ujësjellësit Velçan – Urak njësia Administrative Rrajcë”, Prrrenjas, vlerë kjo e cila përfaqëson një dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore si rrjedhojë e likuidimit të punimeve të pakryera në fakt apo prej mos ndryshimit të zërave në situacion sipas zërit faktit.

6.9.2. Rekomandimi: Nga Bashkia Prrrenjas të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **263,851 lekë** nga operatori ekonomik “R [REDACTED]” sh.p.k, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën nr. 2254/4 prot., datë 19.06.2017 me objekt “Rikonstruksion i ujësjellësit Velçan – Urak njësia Administrative Rrajcë”, Prrrenjas, vlerë kjo e cila përfaqëson penalitetin e pa aplikuar nga ana e Autoritetit Kontraktor Bashkia Prrrenjas ndaj sipërmarrësit të punimeve për vonesa të pa justifikuar në përfundimin në afat të punimeve.

Menjëherë pas përfundimit të procesit gjyqësor

7.10. Gjetje nga auditimi: Subjekti “P [REDACTED] shpk me NIPT L08 [REDACTED], me administrator z. Q [REDACTED] P [REDACTED] ka lidhur kontratë qiraje për një periudhë 20 vjeçare duke filluar

nga data 18.11.2010 deri 19.11.2030 me Vendim të Këshillit të Komunës nr. 47, datë 02.08.2010 (pa noter) me ish-Komunën Qukës përfaqësuar nga ish Kryetari z. Y ■■■ B ■■■, për shfrytëzimin e sipërfaqes së fondit pyjor/kullosor publik në pronësi të ish-Komunës Qukës (sot Njësia Administrative Qukës) prej 15.675 m², e cila ndodhet në ish-miniera Pishkash. Qëllimi i kësaj kontrate është përdorimi i sipërfaqes prej 15.675 m², për “Leje shfrytëzimi të shkëmbinjve gëlqeror me objekt ndërtimi i nyjës së inerteve”. Vlera e kontratës është përcaktuar 37,000 lekë, e cila është në kundërshtim me VKM nr. 1064, datë 22.12.2010 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin pyjorë dhe kullotave”, që është 440.000 lek/ha/vit për kohëzgjatjen e kontratës nga 6-10 vjet. Vlera e kontratës është llogaritur sipas lidhja 2, pika 9/5, për 1,372,000 lekë më pak nga vlera e kontratës që duhej llogaritur sipas lidhjes 2, pika 6/1 (*trajtuar më hollësisht në faqet 101 - 102 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

7.10.1. Rekomandimi. Bashkia Prrenjas të marrë masa për llogaritjen dhe arkëtimin e vlerës prej **1,372,000 lekë** nga “P ■■■ shpk me NIPT L08 ■■■”, me administrator z. Q ■■■ P ■■■ llogaritur më pak nga përcaktimet në kuadrin rregullator në fuqi, sipërcituar.

Menjëherë pas përfundimit të procesit gjyqësor

8.11. Gjetje nga auditimi: Sa trajtuar faqen 21 të Raportit Përfundimtar të Auditimit, pasqyra e vendimeve gjyqësore për largime të padrejta nga puna, është konstatuar se nga z. H ■■■ H ■■■ me detyrë jurist, nuk janë apeluar vendimet e gjykatës së shkallës së parë për dy raste, z. S ■■■ H ■■■, Vendimi nr. 173, datë 28.02.2017, për shpërblim nga bashkia në shumën 607,466 lekë dhe z. E ■■■ D ■■■ Vendimi nr. 1099, datë 15.12.2016, për shpërblim nga bashkia në shumën 773,427 lekë, veprime dhe mosveprime këto që kanë shkaktuar **dëmin ekonomik pa mundësi arkëtimi në shumën prej 1,380,893 lekë.**

8.11.1 Rekomandimi: Bashkia Prrenjas të analizojë rastet sa më sipër dhe, për veprimet dhe mosveprimet e z. H ■■■ H ■■■ me detyrë jurist, me pasojë dëm ekonomik për buxhetin e bashkisë pa mundësi arkëtimi, në shumën prej 1,380,893 lekë, të nxjerrë përgjegjësit dhe të marrë masat përkatëse administrative.

Menjëherë

4.BASHKIA BELSH:

- Nga verifikimi rezulton se KLSH ka dërguar në Bashkinë Belsh rekomandimet e auditimit me shkresën e saj nr. 06/9, datë 14.05.2018 protokolluar në Bashkinë Belsh me shkresën nr.1188 prot, datë 15.05.2018, ndërsa nga Bashkia Belsh për zbatim e rekomandimeve të KLSH nuk është kthyer përgjigje në kundërshtim me ligjin nr.154/2014, datë 27.11.2014 “Për funksionimin dhe organizimin e KLSH”, Neni 15, Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së, ku përcaktohet se: Kontrolli i Lartë i Shtetit, sipas rastit, në fillim, përgjatë dhe/ose në përfundim të veprimtarisë, duhet: j) të vendosë një afat kohor për zbatimin e rekomandimeve dhe të informohet nga subjektet e audituara ose institucionet më të larta rreth programeve të tyre, për të zbatuar rekomandimet e bëra sipas paragrafëve të mësipërm, brenda 20 ditëve nga data e marrjes së kërkesës.

- Nga verifikimi rezulton se përfundimet e auditimit i janë dërguar subjektit të audituar Bashkisë Belsh, me shkresën e Kryetarit të KLSH nr. 6/9, datë 14.05.2018 dhe duhet të raportonte në KLSH brenda 6 muajve ose brenda datës 14.11.2018, duke mos zbatuar ligjin nr.154/2014 datë 27.11.2014 “Për funksionimin dhe organizimin e KLSH (referuar nenit 30, pika 2 e ligjit nr.154/2014 datë 27.11.2014 “Për funksionimin dhe organizimin e KLSH, për raportimin brenda 6 muajve nga marrja e njoftimit të RPA).

- Nga verifikimi rezulton se Bashkia Belsh nuk ka hartuar planin e veprimit të zbatimit të rekomandimeve të dërguara nga KLSH me shkresën nr. 6/9, datë 14.05.2018, në kundërshtim me ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, Neni 50-Auditimi i jashtëm ku përcaktohet se: 5. Për të gjitha raportet e auditimit të jashtëm, të kryera nga Kontrolli i Lartë i Shtetit apo auditues të tjerë ligjorë, kryetari i njësive të vetëqeverisjes vendore përgatit një plan veprimi për zbatimin e rekomandimeve të raportit të auditimit.

A. MASA ORGANIZATIVE:

Nga KLSH janë rekomanduar Bashkisë Belsh 21 masa organizative, të cilat janë pranuar dhe prej tyre, nuk është zbatuar plotësisht asnjë masë, janë në proces zbatimi 9 masa dhe 12 masa organizative nuk janë zbatuar për të cilat rikërkojmë zbatimin e masave si vijon:

1.1. Gjetje nga auditimi: Bashkia Belsh nuk ka **ngritur një sistem efektiv të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, duke mos hartuar një kuadër të plotë rregullash të shkruara për funksionimin e institucionit.** Nuk janë hartuar rregulla për ruajtjen e aktiveve. **Nuk është hartuar** rregullore e kodit të etikës, arkivës, regjistri i riskut, gjurma e auditimit, si dhe nuk është ngritur grupi për menaxhimin strategjik. Mungon kryerja e analizës së funksionimit të sistemit të kontrollit të brendshëm nga titullari, duke mos përcaktuar mangësitë dhe masat që duhen marrë, në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 10296, **datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, neni 8, 16, 22, 23, 24** (Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqe 23-24 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1.1 Rekomandim: Nga Kryetari i Bashkisë Belsh të hartohet një kuadër i plotë rregullash të shkruara, për secilin sektor dhe drejtori, të cilat ndihmojnë stafin në kryerjen sa më mirë të detyrës funksionale. Të hartohet rregullorja e kodit të etikës, arkivës, regjistri i riskut, si dhe për proceset kryesore të punës që zhvillohen në institucion të hartohet gjurma e auditimit dhe lista e proceseve të punës. Të monitorohet nga titullari sistemi i kontrollit të brendshëm, duke bërë përmirësimet e nevojshme në vazhdimësi.

Menjëherë

2.2. Gjetja nga auditimi: Nga IVMT janë nxjerrë pesë vendime administrative me gjobë në vlerë e mbetur **2,500,000 lekë**, e cila nuk është arkëtuar, duke shkaktuar të **ardhura të munguara** për buxhetin e njësisë vendore. Nuk janë marrë masa në rrugë administrative e gjyqësore për arkëtimin e tyre, veprime në kundërshtim me neni 16, të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve” i ndryshuar, ligjin nr. 10279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative”. Për vendimet e gjobave të pa arkëtuara nuk janë llogaritur vlera e kamatëvonesave. Nga IMTV dhe Drejtoria Juridike, nuk është kërkuar në Gjykatën Administrative kthimi i vendimeve të gjobave në tituj ekzekutiv (Më hollësisht trajtuar në pikën 6, faqe 195-198 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2.2.1. Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Belsh të nxjerrë përgjegjësitë për mos arkëtimin e 5 gjobave të vendosura në vlerën **2,500,000 lekë**, mos kthimin e tyre në titull ekzekutiv dhe mos llogaritjen e kamatë-vonesave. Në vazhdim të marrë të gjitha masat nëpërmjet strukturave përkatëse, Sektorit të IMTV, Sektorit Juridik, Drejtorisë Ekonomike, për arkëtimin e vlerës së gjobës dhe kamatëvonesës, duke kërkuar kthimin e vendimeve të gjobave në tituj ekzekutiv. Arkëtimi të kërkohej prej kundërvajtjesve për të cilët është aplikuar gjoba: I ■ D ■ F ■ X ■ V ■ T ■, P ■ Z ■, F ■ S ■ në vlerë të barabartë prej **500,000 lekë për secilin**. Në rast të pamundësisë së kërkimit të pagesës nga qytetarët për shkak të kalimit të afateve (parashkrimit), kjo vlerë të kërkohej prej personave të cilët nuk kanë marrë masa në kohë për arkëtim.

Menjëherë

3.3. Gjetje nga auditimi: Në objektin “Ndërtimi i pedonaleve dhe korsive të biçikletave, Performanca dhe realizimi i veprave të artit, Liqeni Belsh”, nga auditimi rezulton se në Zonën A nuk është vendosur bordura 20x35 cm, sipas projekt-preventivit, por bordurë 20x30 cm. Gjithashtu, vendosja e 78 copë shtylla metalike për ndriçim me H=3m, d=160 mm, nuk është bërë sipas specifikimeve teknike, pasi diametri i shtyllave të vendosura në vepër është mesatarisht 80 mm. Gjithashtu në këtë objekt nuk ka asnjë të dhënë rreth zbatimit të tij. Ndërmjet sipërmarrësit dhe AK nuk ka asnjë komunikim shkresor rreth ecurisë së zbatimit të kontratës. Punimet për këtë objekt nuk janë kryer dhe nga ana e AK nuk është marrë asnjë masë për ndjekjen e zbatimit të

kësaj kontrate (*Më hollësisht trajtuar në pikën 4.b, faqe 140-145 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

3.3.1. Rekomandim: Nga Bashkia Belsh të merren masa për zëvendësimin e bordurave të vendosura, me bordura 20x35 cm dhe të shtyllave të ndriçimit, me shtylla metalike për ndriçim me H=3m, d=160mm, sipas specifikimeve teknike të projektit dhe dokumenteve standarde të tenderit. Në rast pamundësie, Bashkia Belsh të negociojë me Sipërmarrësin e Punimeve për një çmim të ri, më të ulët se çmimi i situacionuar dhe pas rilogaritjes së diferencës të kërkojë në rrugë ligjore arkëtimin e shumës së dakordësuar. Nga Bashkia Belsh të merren masa për ndjekjen dhe monitorimin e zbatimit të këtij objekti sipas kontratës dhe nxjerrjen e përgjegjësive për gjendjen e deritanishme.

Menjëherë

4.4. Gjetje nga auditimi: Në riparimin e automjeteve konstatohen praktika të blerjes së pjesëve të këmbimit nga vetë institucioni dhe vendosja e tyre nga punonjës të tij, shërbime jo profesionale të cilat nuk garantojnë cilësi. Gjithashtu në një rast është bërë shërbim automjeti emergjent për riparime të rëndësishme të cilat kapërcejnë gjendjen e emergjencës si nga vlera edhe nga numri i shërbimeve të kryera (*Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe 47-50 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

4.4.1. Rekomandim: Bashkia Belsh për riparimin e automjeteve të ndjekë praktika të cilat bëjnë të mundur që më parë të bëhet përcaktimi i defekteve e nevojave konkrete të mjetit në servis të licencuar dhe mbi bazën e certifikatës së lëshuar prej tij të kryhen riparimet e nevojshme, duke eliminuar blerjen e pjesëve të këmbimit dhe vendosjen e tyre nga vetë punonjësit. Në mënyrë që të eliminohen përsëritjet në kryerjen e shërbimeve të njëjta dhe nga operatori ekonomik të rritet përgjegjësia, prej tij të kërkohet garanci për shërbimin e kryer.

Menjëherë

5.5. Gjetje nga auditimi Me fondet e Bashkisë Belsh në vitin 2017 është kryer prokurim në vlerën **3,816,000 lekë** për blerjen e 2,000 matsave të ujit, me çmim 1908 lekë/copa, për llogari të shoqërisë “U [REDACTED]” SHA, e cila ka fondet dhe buxhetin e vet. Nga Bashkia nuk janë marrë masa për kthimin e vlerës së mësipërme në buxhetin e njësisë vendore, pasi bazuar në kontratën e ujit të pijshëm midis abonentit dhe “Uj [REDACTED]” sh.a, vlera e matsave paguhet nga qytetarët. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe 47-50 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

5.5.1. Rekomandim: Bashkia Belsh në bashkëpunim me shoqërinë “U [REDACTED]” SHA të marrë masa për kthimin në llogarinë e vetë, të vlerës plotë prej **3,816,000 lekë** shpenzuar për blerjen e 2,000 matsave të ujit të pijshëm për llogari të “U [REDACTED]”sha, në të kundërtën të paguhet nga urdhëruesit e blerjes së matësve të ujit të pijshëm.

Menjëherë

6.6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se ka diferenca të dukshme midis treguesve të hartimit dhe zbatimit të buxhetit. Në total treguesit e buxhetit janë realizuar në masën 79,5 %, nga i cili zëri “Investime”, është realizuar me vlerën më të ulët, ose në masën 53.7%. Për vitin 2017, treguesit e buxhetit janë realizuar në masën 78.5%, nga i cili zëri investime është realizuar në 59%. Planifikimi i zërave të shpenzimeve dhe investimeve dhe mos realizimi i tyre për shkak të mos realizimit të të ardhurave sjellin mos plotësimin e nevojave reale të komunitetit dhe ulje të performancës të njësisë vendore në drejtim të këtyre shërbimeve. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe 24-30 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

6.6.1.Rekomandim: Në mënyrë që të mos krijohen diferenca të dukshme midis parashikimit dhe realizimit të buxhetit, Bashkia Belsh të marrë masa për hartimin e një buxheti real, mbështetur në realizimin e mundshëm e objektiv të të ardhurave.

Menjëherë

7.7. Gjetje nga auditimi: Si rezultat i moszbatimit nga institucioni të procedurave ligjore për largimin e punonjësve nga puna në Bashkinë Belsh u konstatua efekt negativ financiar në buxhet në vlerën **1,496 mijë lekë**, efekte të cilat janë të mundura të eliminohen nga institucioni, duke ndjekur procedurat e duhura ligjore për largimit e punonjësit nga puna. Përpara zbatimit të

vendimit gjyqësor, nga titullari nuk janë nxjerrë përgjegjësitë administrative dhe nuk është nxjerrë akti që provon gjurmën e auditimit të këtij procesi, në kundërshtim me kërkesat e pikës 62 të udhëzimit nr.2, datë 06.02. 2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”(Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe 33-36 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

7.7.1. Rekomandim: Në rastet e ndërprerjes së marrëdhënieve të punës me punonjësit, nga institucioni të zbatohen të gjitha procedurat ligjore të largimit, me qëllim shmangien e efekteve negative në buxhet. Nga titullari, përpara zbatimit të vendimeve gjyqësore, të analizohen këto vendime, të nxirren përgjegjësitë administrative, duke përcaktuar shkakun e ndodhjes së tyre, si dhe të nxiret akti që provon gjurmën e auditimit të këtij procesi.

Menjëherë

8.8. Gjetje nga auditimi: Këshilli i Bashkisë Belsh me vendimin nr. 42, datë 22.07.2016 dhe vendimin nr. 61, datë 29.09.2017, respektivisht ka zbritur me 30% nivelin e taksës së tokës bujqësore për të gjitha vitet e prapambetura nga familjarët dhe me 30% nivelin e taksës së biznesit të vogël për të gjitha bizneset debitore deri në vitin 2015, me pasojë të ardhura të munguara për buxhetin e njësisë vendore në vlerën totale **5,271,713 lekë**, nga e cila 333,113 lekë në ngarkim të subjekteve private dhe 4,938,600 lekë për familjarët. Këto vendime tejkalojnë kompetencat ligjore të pushtetit vendor dhe janë të pa bazuara ligjërisht. Të drejtën për faljen e ka vetëm Kuvendi i Shqipërisë, bazuar në Kushtetutën e RSH, pjesa e trembëdhjetë -Financat Publike, neni 155 përcaktohet: *Taksat, tatimet dhe detyrimet financiare kombëtare, lehtësimi ose përjashtimi prej tyre i kategorive të caktuara të pagesave, si dhe mënyra e mbledhjes së tyre të caktuar me ligj.* Për këtë arsye, të gjitha diferencat që rrjedhin nga kjo ulje e detyrimeve nga këshilli bashkiak, konkretisht në vlerën 333,113 lekë për biznesin dhe në vlerën 4,938,600 lekë për familjarët nga taksa e tokës, të hequra nga kontabiliteti, përbëjnë të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Belsh (Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqe 150-162 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

8.8.1. Rekomandim: Bashkia Belsh, të regjistrojë detyrimin dhe të marrë të gjitha masat e nevojshme ligjore për arkëtimin e vlerës **5,271,713 lekë**, nga e cila **333,113 lekë** në ngarkim të subjekteve private dhe vlera **4,938,600 lekë** për familjarët të cilët kanë përfituar nga falja e paligjshme e bërë nga këshilli bashkiak (sipas listave të trajtuara në anekset e Raportit Përfundimtar)

Menjëherë

9.9. Gjetje nga auditimi: Nga sektori i taksave dhe tarifave vendore të Bashkisë Belsh, nuk janë marrë masat e duhura për kontrollin e subjekteve juridikë dhe fizikë që ushtrojnë aktivitet në territorin e Bashkisë Belsh. Nga grupi i auditimit u bë sondazh në faqen zyrtare të QKB-së për sektorin e peshkimit dhe u konstatua se ka një sasi të konsiderueshme biznesesh që nuk figurojnë në regjistrat e tatimpaguesve të Bashkisë Belsh, me pasojë të ardhura të munguara për detyrimet e taksave e tarifave vendore në vlerën **1,865,070 lekë**, veprime në papajtueshmëri me nenin 40 e 41, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar (Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqe 150-162 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

9.9.1.Rekomandim: Bashkia Belsh të marrë masa për regjistrimin e subjekteve të pa regjistruar e të konstatuar nga KLSH-ja sipas listës së lënë në këtë projekt raport me vlerat përkatëse, të regjistrojë detyrimin **1,865,070 lekë** dhe të kërkojë sipas ligjit arkëtimin e tij. Të zhvillojë në vazhdimësi korrespondencë me QKB-në dhe Drejtorinë Rajonale Tatimore të rrethit Elbasan për evidentimin dhe regjistrimin e të gjithë subjekteve që zhvillojnë aktivitet në njësinë vendore.

Menjëherë

10.10. Gjetje nga auditimi: Si rezultat i mos marrjes së masave të duhura për vjeljen e taksave dhe tarifave vendore, deri në datën 31.12.2017 janë krijuar debitorë në vlerën totale **59,912,431 lekë e ardhur e munguar**, nga e cila vlera **5,878,132 lekë** nga debitorët biznese privat dhe vlera **54,034,299 lekë** nga debitorët e kategorisë familjare për taksën e tokës bujqësore (Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqe 150-162 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

10.10.1-Rekomandim: Zyra e taksave dhe tarifave vendore, në bashkëpunim me drejtorinë ekonomike dhe atë juridike, të marrë masa për arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifave vendore në vlerën **59,912,431** lekë. Për bizneset, bazuar në nenin 70 pika 3 “E drejta për të nxjerrë njoftimin e vlerësimit tatimor”, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, **të nxirren njoftim vlerësimet tatimore për debitorët dhe të ndiqen rrugët e mëposhtme:**

a-Tu dërgohen bankave të nivelit të dytë urdhrat e bllokimit të llogarive bankare, bazuar në nenin 90 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 ”Për procedurat tatimore RSH”.

b-Të dërgohet në Drejtorinë Rajonale të Transportit, kërkesa për vendosjen e barrës siguroese (për mjetet) dhe në ZVRPP (për pasuritë e paluajtshme), bazuar në nenin 91 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 ”Për Procedurat Tatimore në RSH”.

c- Për subjektet të cilët nuk paguajnë detyrimet tatimore në afat, bazuar në nenin 114, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008, “Për Procedurat tatimore në RSH “ të ndryshuar, me ligjin nr. 164/2014 datë 15.12.2014, ndaj tyre të llogariten në vazhdimësi kamat vonesa.

d-Në rast se bizneset private edhe pas njoftimeve zyrtare dhe dërgimit të urdhër bllokimeve në bankë nuk kryejnë pagesën e detyrimeve, pasi të merren masat administrative apo sekuestro, të bëhet kallëzim penal, bazuar në Kodin Penal të R.SH, miratuar me ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995 me ndryshimet e mëvonshme, neni 181,-*Mospagimi i taksave dhe tatimeve.*

e. Zyra e taksave dhe tarifave vendore të evidentojë dhe listojë në mënyrë elektronike **abonentët familjarë** dhe të merren masa për arkëtimin e taksës së tokës **nga fermerë**, sipas të dhënave që disponon Gjendja Civile, **të njoftohen** tatimpaguesit familjarë **edhe në median lokale** të Bashkisë për të paguar detyrimin tatimor. Në zbatim të pikës 71, të udhëzimit plotësues të Ministrisë Financave nr. 01, datë 15.01.2016 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2017”, njoftim vlerësimet t’ju dërgohen nëpërmjet Zyrës Postare familjarëve të cilët nuk kanë paguar detyrimet për taksën/tarifën e pastrimit, ndriçimit, banesave, gjelbërimit etj.

Menjëherë

11.11. Gjetje nga auditimi: Nga verifikimi, për subjektet që tregtojnë hidrokarbure dhe nënprodukte të tyre, u konstatua se 8 subjekte me aktivitet tregtinë e karburanteve nuk figurojnë të regjistruar në të dhënat e bashkisë për liçencat e tregtimit të hidrokarbureve. Sa më sipër, për subjektet që nuk kanë depozituar të dhënat në sektorin e të ardhurave në Bashkinë Belsh, konsiderohen si subjekte debitore në lidhje me pagesën për liçencimin (autorizimin) e tregtimit të hidrokarbureve, në vlerën **8,000,000 lekë** e cila përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Belsh. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me VKM nr. 170, date 25.4.2002 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e lejeve e të autorizimeve për tregtimin e naftës, gazit e nënprodukteve të tyre”, paragrafi III (*Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqe 150-162 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

11.11.1. Rekomandim: Bashkia Belsh, të kontabilizojë shumën e detyrimit **8,000,000 lekë** në ngarkim të subjekteve debitore, sipas listës së lënë nga KLSH dhe të kërkojë prej tyre arkëtimin e kësaj vlere, duke aplikuar masat shtrënguese ligjore si urdhër bllokimi në bankë apo vendosje të barrës siguroese.

Menjëherë

12.12. Gjetje nga auditimi: Në territorin e Bashkisë Belsh, ushtrojnë aktivitet peshkimi rreth 40 subjekte peshkimi, 2 subjekte grumbullimi të bimëve medicinale dhe 3 subjekte minerare ose inertesh, me të cilat Bashkisë Belsh nuk ka lidhur kontratë për shfrytëzimin e sipërfaqeve sipas lejeve minerare apo të tjera dhe se asnjëri prej këtyre subjekteve nuk ka kontratë me Bashkinë për shfrytëzimin e aseteve të saj. Pavarësisht se këto kontrata shfrytëzimi mund të jenë lidhur nga Ministrinë e linjës apo institucione të tjera, në bazë të legjislacionit në fuqi, të ardhurat e përfutuara nga përdorimi apo shfrytëzimi i pasurive të njësisë vendore duhet të derdhen në buxhetin e njësisë vendore.

Nga ana e bashkisë nuk është zhvilluar asnjë korrespondencë për të kërkuar informacion në institucionet përkatëse që merren me liçencimin apo kontraktimin e këtyre subjekteve (*Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqe 150-162 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

12.12.1.Rekomandim: Bashkia Belsh, të zhvillojë korrespondencë me institucionet përkatëse në lidhje me evidentimin dhe plotësimin e regjistrave të saj me subjektet që zhvillojnë aktivitet duke shfrytëzuar asetet e Bashkisë në çfarëdolloj forme dhe të lidhë kontrata me këto subjekte, jo vetëm për të përfituar nga shfrytëzimi i këtyre pasurive, por edhe për t'i mbrojtur këto asete, florën dhe faunën e territorit të saj.

Menjëherë

13.13. Gjetje nga auditimi: Struktura e policisë bashkiake në Bashkinë Belsh nuk është krijuar si sektor më vete, me emërtimin përkatës sipas kërkesave ligjore. Ky sektor funksionon si Inspektoriat i Menaxhimit të Territorit dhe jo si Polici Bashkiake, në kundërshtim me ligjin nr. 8224, datë 15.5.1997 “Për organizimin dhe funksionimin e policisë të bashkisë dhe të komunës”, i ndryshuar.

Emërimet e punonjësve të policisë bashkiake nuk janë bërë nëpërmjet komisionit të përzgjedhjes së kandidatëve, por nga Kryetari i Bashkisë Belsh, në kundërshtim me nenin 5 të ligjit të sipërpërmendur dhe nenit 11 të Rregullores së brendshme “TIP” të Policisë Bashkiake, miratuar me Urdhrin e Përbashkët të Ministrisë së Pushtetit Vendorë dhe Ministrisë së Rendit Publik nr. 1, datë 17.04.2003 “Për miratimin e rregullores TIP të policisë bashkiake dhe të komunës”. Për emërimet e kryera nuk është marrë në konsideratë kriteri i moshës, nuk ka asnjë të dhënë nëse punonjësit e policisë i janë nënshtruar ose jo betimit, në zbatim të nenit 6, të Rregullores së sipërpërmendur.

Me punonjësit e policisë bashkiake, nuk janë lidhur kontrata pune me afat mbi dy vjet sipas kërkesave në aktet ligjore dhe nënligjore të cituara më sipër (*Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqe 150-162 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

13.13.1.Rekomandimi: Nga Bashkia Belsh të merren masa për krijimin e strukturës së Policisë Bashkiake të pavarur nga drejtoritë e tjera. Në rastet e marrjes së punonjësve të rinj në punë të zbatohet procedura e përzgjedhjes nga komisioni i posaçëm, t’u nënshtrohen betimit sipas formulës së përcaktuar nga ligji, të respektohen kriteret e moshës, arsimit, kualifikimeve etj.

Punonjësit e Policisë Bashkiake t’i nënshtrohen trajnimeve dhe kualifikimeve, sipas përcaktimeve ligjore. Të realizohet lidhja e kontratave të punës me afat mbi dy vjeçar.

Menjëherë

14.14. Gjetje nga auditimi: Asetet e transferuara në pronësi të Bashkisë Belsh dhe NJA që përmbledh kjo bashki nuk janë marrë në dorëzim me procesverbale. Dokumentacioni dhe të dhënat përkatëse në lidhje me asetet e Bashkisë janë vënë në dispozicion me shkresa zyrtare nga AITPP-ja, nëpërmjet VKM-ve përkatëse. Në lidhje me asetet e Bashkisë Belsh, nga grupi i auditimit u konstatua se nuk janë zbatuar kërkesat e pikës 13 të VKM-së nr. 500, dt. 14.08.2001 “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore”, e cila përcakton se: “Pas regjistrimit në pronësi të ndërtesave administrative dhe të mjediseve përkatëse, bashkitë ose komunat kanë të drejtë dhe janë të detyruara të vendosin çdo aset në librin e llogarive, sipas rregullave kontabël, që zbatohen për qeverisjen vendore. Mbjajtësi i mëparshëm i kësaj prone, nëse është i ndryshëm nga pronari i ri, duhet që, njëkohësisht, ta heqë këtë aset nga librat e tij kontabël. Ky transferim kontabël i asetit do të dokumentohet në aktin e veçantë të transferimit kontabël, të nënshkruar nga të dyja palët”.

Gjithashtu nuk janë zbatuar edhe kërkesat e pikës 21 të po kësaj VKM-je, e cila parashikon: “Që nga çasti i marrjes së listës përfundimtare të pronës, që do të transferohet, çdo njësi e qeverisjes vendore është përgjegjëse për: a) mbajtjen e listës së inventarizimit të këtyre pronave; b) azhurnimin në vazhdimësi të listës së inventarit pas regjistrimit, sa herë që merren prona të reja, jepen ose shiten, ose shfaqen interesa të palëve të treta, siç është dhënia me qira apo hipotekimi.” (*Më hollësisht trajtuar në pikën 7, faqe 198-208 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

14.14.1.Rekomandim: Bashkia Belsh, të marrë masa për funksionimin e komisioneve të ngritura me qëllim identifikimin në terren të gjendjes juridike të aseteve, marrjen në dorëzim, kolaudimin,

vlerësimin, regjistrimin në ZVRPP dhe kontabilizimin e aseteve të qëndrueshme, sipas miratimeve me vendime të Këshillit të Ministrave.

Menjëherë

15.15. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i Aktiveve në bilancin kontabël, u konstatua se në llogarinë 210 “Toka, troje, terrene”, 211 “Pyje, kullota, plantacione” etj., vlera kontabël është e pandryshuar, pasi nuk është bërë asnjë regjistrim i ri në hipotekë dhe rrjedhimisht nuk janë bërë as regjistrimet përkatëse në kontabilitet. Gjithashtu, edhe llogari të tjera të aktivitetit janë të pandryshuara për të njëjtën arsye. Në llogarinë 217 “Kafshë pune e prodhimi” është e regjistruar vlera 288.000 lekë, e cila përfaqëson një donacion shpendësh të egra në vitin 2015 nga Këshilli i Qarkut Elbasan. Kjo llogari nuk pasqyron drejt gjendjen, pasi është e pamundur që një njësi ekonomike të mbajë në kontabilitet shpendët e egra. Edhe sikur këto shpendë të ishin të mbikëqyrura dhe të kontrolluara nga bashkia, duhet të ishin regjistruar në llogarinë 334, “Kafshë në rritje e majmëri (*Më hollësisht trajtuar në pikën 7, faqe 198-208 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

15.15.1. Rekomandim: Bashkia Belsh, të marrë masa për të evidentuar situatat inventariale të këtyre llogarie dhe të bëhen rregullimet përkatëse duke regjistruar dhe administruar me prioritet asetet që kanë interesa të veçanta kulturore, sportive etj., si dhe të rregullojë gjendjen e llogarisë 217 apo llogarive të tjera të së njëjtës natyrë.

Menjëherë

16.16. Gjetje nga auditimi: Nga Bashkia Belsh dhe ish Komunitat, sot Njësi Administrative, nuk është bërë marrja në dorëzim me procesverbale e aseteve të qëndrueshme, nga institucionet e tjera në pronësi të të cilave kanë qenë këto asete, rrjedhimisht nuk është kryer identifikimi, inventarizimi fizik dhe regjistrimi në kontabilitet, nuk është aplikuar në ZVRPP Elbasan për regjistrimin e të gjitha aseteve dhe pasurive të tjera, veprime në kundërshtim me ligjin nr. 8744, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, me pikat 20, 21 dhe 22, të VKM nr. 500, datë 14.8.2001 “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore”, me pikat 37, 42-60, 74, të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”.

Veprimet e mësipërme janë në shkëlqje të kërkesave të ligjit nr. 33-2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, dhe UMF-së nr. 30, datë **27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, kap. III, pika 30** (*Më hollësisht trajtuar në pikën 7, faqe 198-208 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

16.16.1. Rekomandim: Bashkia Belsh të marrë masa për marrjen në dorëzim të aseteve, nëpërmjet komisioneve të ngritura, duke kryer vlerësimin, inventarizimin kontabël dhe fizik dhe të aplikohet në ZVRPP Elbasan për regjistrim e tyre.

Marrja në dorëzim e këtyre pronave dhe aseteve të qëndrueshme të bëhet me procesverbale të nënshkuara nga përfituesi Bashkia Belsh dhe nga institucionet qendrore si dorëzues.

Këto proces-verbale duhet të jenë shoqëruar me hartat përkatëse në zbatim të procedurave ligjore.

Menjëherë

17.17. Gjetje nga auditimi: Në fushën e aseteve, u konstatua se për të gjitha rastet me shënime si “e zënë forcërisht”, “e zaptuar”, etj., nuk ka pasur asnjë denoncim në organet kompetente të zbatimit të ligjit dhe nuk është ndërmarrë asnjë veprim nga ana e strukturave të Bashkisë Belsh, Policia Bashkiake, INUV-ja, etj., për lirimin e pronave dhe aseteve të zëna forcërisht për të vënë në posedim të Bashkisë këto pasuri, të cilat do t’i shërbenin funksionit të saj në shërbim të komunitetit.

Në territorin e Bashkisë Belsh nuk ka asnjë procedurë të kësaj natyre dhe rrjedhimisht nuk ka as procedura apo procese gjyqësore për këtë qëllim (*Më hollësisht trajtuar në pikën 7, faqe 198-208 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

17.17.1. Rekomandim: Nga zyra juridike duhet të fillojnë procedura për ndjekjen në rrugë gjyqësore të problemeve me subjektet debitore dhe me personat që posedojnë padrejtësisht

sipërfaqet e objekteve, trojeve, tokave bujqësore, kullotave, pyjeve, etj., pasuri të cilat duhet të ishin në shërbim të komunitetit.

Menjëherë

18.18. Gjetje nga auditimi: Bazuar në VKM-së nr. 886, datë 03.11.2010, u konstatua se në **110 raste në fushën e aseteve**, për sipërfaqen e përgjithshme të truallit prej **197.941 m²**, prej të cilave sipërfaqe ndërtimi 9.098 m², sipërfaqe funksionale 14.314 m², troje të lira 152.955 m², tokë arë 21.574 m², asetet janë në përdorim të të tretëve, persona privatë. Këto asete janë zënë forcërisht prej këtyre personave.

Duke llogaritur qiranë e munguar për ndërtesat dhe trojet funksionale për periudhën 01.01.2016 deri më 31.12.2017, në vijim të argumentimit të përdorur edhe në rekomandimin e lënë nga grupi i auditimit të mëparshëm të KLSH-së, sipas VKM-së nr. 54, datë 05.02.2014, “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfitozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, të ndryshuar, Kapitulli III, pika 1/a,b, u konstatua një vlerë të ardhura të munguara në shumën e përgjithshme **388,880,328 lekë, për buxhetin e Bashkisë Belsh**, të ardhura të llogaritura vetëm për periudhën e auditimit, të cilat do të realizoheshin nëse do të ishin lidhur kontrata qiraje vetëm për trojet dhe tokat arë “të zëna forcërisht” apo “në përdorim nga të tretët” (Më hollësisht trajtuar në pikën 7, faqe 198-208 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

18.18.1. Rekomandim: Bashkia Belsh, brenda hapësirave ligjore, të shohë mundësinë e arritjes së një marrëveshje me personat përkatës dhe në rast se kjo nuk arrihet, të bëhet denoncim në organet kompetente të zbatimit të ligjit dhe të veprohet në bashkëpunim me strukturat e Bashkisë Belsh, Policinë Bashkiake për lirim të aseteve të zëna forcërisht dhe të vihen këto në posedim të Bashkisë si pasuri në shërbim të komunitetit.

Menjëherë

19.19. Gjetje nga auditimi: Nga ish Komuna Fierzë (sot NJA e Bashkisë Belsh), në datën 03.08.2014 është lidhur kontratë qiraje, numër ska, me kompanisë A [redacted] (sot T [redacted] A [redacted]) për sipërfaqen e truallit 300 m² me çmimin 75 lekë/m², në vend të çmimit prej 100 lekë/m². Për kohëzgjatjen e kontratës gusht 2014-dhjetor 2017 (41 muaj), nga aplikimi i gabuar i çmimit është shkaktuar një e ardhur e munguar në buxhet në vlerën **307,500 lekë** (Më hollësisht trajtuar në pikën 7, faqe 198-208 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

19.19.1. Rekomandim: Bashkia Belsh, të marrë masa për rishikimin e kontratës së qerasë të truallit me kompaninë celulare T [redacted] A [redacted] me synim vendosjen e çmimit të duhur të qerasë, si dhe të arkëtojë detyrimet e prapambetura **307,500 lekë** nga kjo kompani.

Menjëherë

20.20. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i kontratave të qirave për tokën bujqësore shtetërore të pandara, u konstatua se janë konsideruar të lidhura gjithsej 107 kontrata qiraje me persona të ndryshëm për tokat bujqësore të pa ndara për sipërfaqen totale 925,990 m² ose 92.6 ha. Asnjë kontratë, përfshirë ato që janë të noterizuara nuk ka planin e biznesit ose të investimit.

Nga auditimi, u konstatua se në shumicën e rasteve nuk ka kontrata, nuk ka dokumentacion në dosje ose ka vetëm nga një skicë me shkrim dore, nuk janë zhvilluar procedurat e ankandit, nuk janë nënshkrimet e anëtarëve të bordit apo të komisionit të qiradhënies, kontratat nuk janë lidhur në prani të noterit, në kundërshtim me aktet ligjore dhe nënligjore të përmendura më sipër dhe me kërkesat e ligjit nr. 7850, datë 29.7.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar. Kontrata të noterizuara janë vetëm 7 në ish Komunën Fierzë.

Nga mos pagesa e detyrimeve nga qiradhënia e tokave bujqësore shtetërore të pandara u konstatua e ardhur e munguar vlera totale **27,762,281 lekë, nga e cila vlera 2,540,064 lekë** përbën vlerën e kontraktuar të qerasë dhe **vlera 22,222,217 lekë** përbën kamatë-vonesa sipas kontratave lidhur ndërmjet palëve (Më hollësisht trajtuar në pikën 7, faqe 198-208 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

20.20.1. Rekomandim: Bashkia Belsh, të verifikojë ligjshmërinë e procedurave të qiradhënies së tokave bujqësore, (ankandet, vendimet e bordit, etj.), zbatimin e kërkesave kontraktuale në lidhje me kultivimet dhe mirëmbajtjen e këtyre tokave në përputhje me kushtet e kontratave. Të

kontabilizojë shumën e detyrimit **24,762,281 lekë**, në ngarkim të 107 personave fizikë qiramarrës të tokave bujqësore të pandara, të kërkojë sipas ligjit arkëtimin e kësaj vlere, duke ndjekur të gjitha procedurat ligjore administrative e gjyqësore. Për personat që nuk paguajnë detyrimet, të fillojnë procedurat për zgjidhjen e kontratës.

Menjëherë

21.21. Gjetje nga auditimi: Bashkia Belsh është audituar nga KLSH dhe me shkresën nr. 1103/7, datë 5.4.2016 janë dërguar rekomandimet për përmirësimin e gjendjes. Për masat e marra ka njoftuar KLSH-në me shkresën nr. 790/1, datë 28.4.2016 brenda 20 ditëve nga dërgimi i rekomandimeve. Zbatimi i rekomandimeve paraqitet si më poshtë:

-Nga 18 masa për shpërblim dëmi, në vlerën totale 40,846,244 lekë janë zbatuar pjesërisht 8 masa, është arkëtuar vlera e dëmit 398,514 lekë, ose 1% e detyrimit.

Janë bërë 8 kërkesë padi në Gjykatën e Shkallës së Parë në fund të vitit 2017, me vonesa të pa justifikuara në kohë nga institucioni. Është ende pa arkëtuar vlera 40,447,730 lekë.

Në zbatim të rekomandimeve të KLSH, me vendimin nr 67, datë 27.07.2016 janë vendosur gjopa nga APP për **15 punonjës** të Bashkisë në **vlerën totale 970,000 lekë**, të cilat nuk është arkëtuar. Nga titullari dhe strukturat e tjera përkatëse të bashkisë nuk janë marrë masat e duhura për realizimin e rekomandimeve (*Më hollësisht trajtuar në pikën 1, faqe 24-30 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

21.21.1. Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Belsh të hartojë plan pune të veçantë e të marrë të gjitha masat e duhura ligjore për zbatimin e rekomandimeve të pa zbatuara të KLSH në auditimin e mëparshëm, dërguar nga KLSH me shkresën nr. 1103/7, datë 5.4.2016, rikërkuar me shkresën 1113/113 datë 31.01.2017, trajtuar më hollësisht në Akt konstatimin nr 5, datë 08.03.2018 “Për zbatimin e rekomandimeve”.

Menjëherë

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI:

Bazuar në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” neni 15 germa (b) dhe (c) –*Të drejtat e KLSH* dhe mbështetur në nenet 98-102, të ligjit nr. 44/2015, datë 30.04.2015 “Kodi i procedurave administrative në Republikën e Shqipërisë”, nenet 21-33, të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” dhe pikën 93, të udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, nga **Titullari i Njësisë Publike**, të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohej në rrugë ligjore (Padi Gjyqësore), duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit. **Nëpunësi zbatues** të ndjekë procesin dhe të kryej regjistrimet e nevojshme kontabël përfundimtare, me qëllim shpërblimin e dëmit në vlerën **78,974,922 lekë**, si më poshtë:

Nga verifikimi rezultoi se vlera e rekomanduar nuk është kontabilizuar vlera prej 78,974,922 lekë.

Nga verifikimi rezultoi se nga vlera e rekomanduar nga KLSH prej..... **78,974,922** lekë

-Deri më datën 30.11.2018 është arkëtuar shuma prej0 lekë

Kanë mbetur pa u arkëtuar vlera prej..... **78,974,922**lekë

Në mënyrë të detajuar masat shpërblim rikërkojmë si më poshtë:

1.1. Gjetje nga auditimi: Në objektin “*Projekti Ansambli Rilindja, Belsh*”, ku nga auditimi i projektit, specifikimeve teknike, dokumentacionit teknik të zbatimit, mbikëqyrjes dhe kolauditimit të punimeve të ndërtimit të administruara në dosjen teknike rezultoi se sheshi kryesor dhe pranë godinave, sipas projektit ishte parashikuar të shtrohej me gurë troktolit, ndërsa pllakat e gurit të

shtruara në sheshin kryesor dhe pranë godinave, nuk janë pllaka prej guri troktolit (formacion shkëmbor magmatike), por një pjesë janë pllaka guri të marrë nga formacione shkëmbore ranore të imta (kategoria sedimentarë) dhe një pjesë janë pllaka guri të marrë nga formacione shkëmbore gëlqerore (kategoria sedimentarë).

Vlera totale e paguar në situacionin përfundimtar për zërin “Shtrim me pllaka guri troktolit” është **51,820,470 lekë pa TVSH**, vlerë e cila është shpenzuar nga autoriteti kontraktor për një zë punimesh, i cili nuk është realizuar nga operatori ekonomik, sipas specifikimeve të projektit, preventivit dhe termave të referencës të dokumenteve standarde të tenderit. Në dosje nuk administrohen çertifikatat e cilësisë së materialeve të përdorur, përfshirë edhe certifikatën e gurit troktolit.

Gjithashtu është audituar dhe objekti për realizimin e dy pedonaleve “Ndërtimi i pedonaleve dhe korsive të biçikletave, Liqeni Belsh” Nr.pa protokoll datë 18.07.2017, vazhdimësi e sheshit kryesor dhe korsive të biçikletave, të cilat janë pjesa integrale e “Projektit të Ansambilit Rilindja”, të realizuara nga po i njëjti sipërmarrës “Vëllezërit Hysa” SHPK, ku u konstatua se në pjesën e majtë është realizuar me “Trotuar me pllaka me përbërje guri gëlqeror”, identike me pllakat e përdorura për një pjesë të sheshit kryesor dhe pranë godinave të “Ansambilit Rilindja”, por të realizuara me çmimin 3500 lekë/m². Diferenca e çmimit njësi është 6500 lekë/m² -3500 lekë/m² =3000 lekë/m². Për volumin e punës 7972.38 m², diferenca në vlerë është **23,917,140** lekë pa TVSH. Në qoftëse do të ishte aplikuar i njëjti çmim edhe për pllakat e vendosura (të cilat nuk janë pllaka troktolite) në objektin “Projekti Ansambli Rilindja”, për këtë zë punimesh, autoriteti kontraktor do të kishte shpenzuar më pak 23,917,140 lekë pa T.V.SH , vlerë e cila përbën dëm ekonomik për Buxhetin e Shtetit dhe Njësisë Vendore.

(Më hollësisht trajtuar në pikën III.4.b., faqe 125-127 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

1.1.1. Rekomandim: Nga Bashkia Belsh të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **23,917,140 lekë pa TVSH**, nga operatori ekonomik “V [REDAKTUAR] H [REDAKTUAR]” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën pa nr. prot datë 19.07.2016, me objekt “Projekti Ansambli Rilindja, Belsh”, vlerë kjo e cila përbën dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si rrjedhojë e likuidimit të punimeve të kryera jo sipas specifikimeve teknike të projektit, preventivit dhe termave të referencës të dokumenteve standarde të tenderit. ***Në rast të zëvendësimit të pllakave të sheshit me pllaka konform specifikimeve teknike të projektit dhe dokumenteve të tenderit, ky dëm ekonomik shuhet.***

Menjëherë

2.2. Gjetje nga auditimi: Në objektin “Projekti Ansambli Rilindja, Belsh”, nga auditimi i projektit, dokumentacionit teknik të zbatimit, mbikëqyrjes dhe kolaudimit të punimeve të ndërtimit të administruara në dosjen teknike rezultuan diferenca në volume pune të likuiduara por të pakryera në fakt në vlerën 15,524,588 lekë, rritje fiktive e çmimit të zërave në vlerën 2,686,994 lekë dhe llogaritje të TVSH për pajisje në vlerën 228,000 lekë. Vlera totale e mësipërme prej **18,439,582 lekë pa TVSH** përbën dëm ekonomik për buxhetin e njësisë vendore. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. - prot., datë 19.07.2016 dhe kontratës shtesë nr. - prot., datë 10.02.2017 të lidhur mes Titullarit të Autoritetit Kontraktor Bashkia Belsh dhe OE “V [REDAKTUAR] H [REDAKTUAR]” SHPK *(Më hollësisht trajtuar në pikën 4.b, faqe 125-128 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

2.2.1. Rekomandim: Nga Bashkia Belsh të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **18,439,582 lekë pa TVSH** nga operatori ekonomik “V [REDAKTUAR] H [REDAKTUAR]” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit sipas kontratës së punimeve nr. - prot datë 19.07.2016 dhe kontratës shtesë nr. - prot., datë 10.02.2017 me objekt “Projekti Ansambli Rilindja, Belsh”, vlerë kjo e cila përbën dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore si rrjedhojë e likuidimit të punimeve të pakryera në fakt, mos ndryshimit të çmimit të zërave në situacion sipas zërit faktik dhe llogaritjes së TVSH për pajisjet.

Menjëherë

3.3. Gjetje nga auditimi: Në objektin “*Sistemim Asfaltim Rruga Belsh - Qafë Shkallë*”, Belsh, nga auditimi i dokumentacionit teknik të zbatimit, mbikëqyrjes dhe kolaudimit të punimeve të ndërtimit të administruara në dosjen teknike rezultuan diferenca në volume pune të likuiduara por të pakryera në fakt në vlerën **11,466,250 lekë pa TVSH** e cila përbën dëm ekonomik. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. - prot datë 11.10.2016 të lidhur midis Titullarit të Autoritetit Kontraktor Bashkia Belsh dhe OE “V [REDACTED] H [REDACTED]” SHPK (Më hollësisht trajtuar në pikën 4.b, faqe 130-133 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

3.3.1. Rekomandim: Nga Bashkia Belsh të merren masa për arkëtimin e vlerës **11,466,250 lekë pa TVSH** nga operatori ekonomik “V [REDACTED] H [REDACTED]” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën nr. - prot datë 11.10.2016 me objekt “*Sistemim Asfaltim Rruga Belsh-Qafë Shkallë*”, vlerë kjo e cila përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore si rrjedhojë e likuidimit të punimeve të pakryera në fakt apo prej mos ndryshimit të zërave në situacion sipas zërit faktit.

Menjëherë

4.4. Gjetje nga auditimi: Në objektin “*Ndërtim, sistemim dhe asfaltim, rruga Trojas*”, Belsh, nga auditimi i projektit, dokumentacionit teknik të zbatimit, mbikëqyrjes dhe kolaudimit të punimeve të ndërtimit të administruara në dosjen teknike rezultuan diferenca në volume pune të likuiduara por të pakryera në fakt, në vlerën **9,306,120 lekë pa TVSH**. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve pa nr. prot., datë 18.04.2017, të lidhur mes Titullarit të Autoritetit Kontraktor Bashkia Belsh dhe BOE “S [REDACTED] N [REDACTED] P [REDACTED] & E [REDACTED]” SHPK (Më hollësisht trajtuar në pikën 4.b, faqe 146-149 të Raportit Përfundimtar).

4.4.1. Rekomandim: Nga Bashkia Belsh të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **9,306,120 lekë pa TVSH**, nga BOE “S [REDACTED] N [REDACTED] P [REDACTED] & E [REDACTED]” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën pa nr. prot datë 18.04.2017, me objekt “*Ndërtim, sistemim dhe asfaltim, rruga Trojas*”, Belsh, vlerë kjo e cila përbën dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si rrjedhojë e likuidimit të punimeve të pakryera në fakt.

Menjëherë

5.5. Gjetje nga auditimi: Në objektin “*Ndërtimi i pedonaleve dhe korsive të biçikletave, Liqeni Belsh*”, nga auditimi i projektit, dokumentacionit teknik të zbatimit, mbikëqyrjes dhe kolaudimit të punimeve të ndërtimit të administruara në dosjen teknike rezultuan diferenca në volume pune të likuiduara por të pakryera në fakt në vlerën 1,916,128 lekë, si dhe rritje fiktive e çmimit të zërave në vlerën 1,090,577 lekë. Në total vlera prej **3,006,705 lekë pa TVSH** përbën dëm ekonomik. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve pa nr. prot datë 18.07.2017, të lidhur mes Titullarit të Autoritetit Kontraktor Bashkia Belsh dhe OE “V [REDACTED] H [REDACTED]” SHPK (Më hollësisht trajtuar në pikën 4.b, faqe 142-145 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

5.5.1. Rekomandim: Nga Bashkia Belsh të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **3,006,705 lekë pa TVSH**, nga operatori ekonomik “V [REDACTED] H [REDACTED]” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën pa nr. prot datë 18.07.2017, me objekt “*Ndërtimi i pedonaleve dhe korsive të biçikletave, Liqeni Belsh*”, vlerë kjo e cila përbën dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si rrjedhojë e likuidimit të punimeve të pakryera në fakt.

Menjëherë

6.6. Gjetje nga auditimi: Në objektin “*Rikualifikim Urban i fasadave të qendrës*”, Belsh, nga auditimi i dokumentacionit teknik të zbatimit, mbikëqyrjes dhe kolaudimit të punimeve të ndërtimit të administruara në dosjen teknike rezultuan diferenca në volume pune të likuiduara por të pakryera në fakt në vlerën **1,183,595 lekë pa TVSH**. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. - prot datë 11.09.2017 të lidhur mes Titullarit të Autoritetit Kontraktor Bashkia Belsh dhe OE “F [REDACTED] C [REDACTED]” SHPK (Më hollësisht trajtuar në pikën 4.b, faqe 139-141 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

6.6.1. Rekomandim: Nga Bashkia Belsh të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **1,183,595 lekë pa TVSH** nga operatori ekonomik “F [REDACTED] C [REDACTED]” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit

në kontratën nr. - prot datë 11.09.2017 me objekt “Rikualifikim Urban i fasadave të qendrës”, Belsh, vlerë kjo e cila përfaqëson një dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore si rrjedhojë e likuidimit të punimeve të pakryera në fakt apo prej mos ndryshimit të zërave në situacion sipas zërit faktit.

Menjëherë

7.7. Gjetje nga auditimi: Në objektin “Përmirësimi i kushteve të banimit të komunitetit Rom/Egjiptian”, Belsh, nga auditimi i dokumentacionit teknik të zbatimit, mbikëqyrjes dhe kolaudimit të punimeve të ndërtimit të administruara në dosjen teknike rezultuan diferenca në volume pune të likuiduara por të pakryera në fakt në vlerën **70,559 lekë pa TVSH**. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. - prot datë 15.08.2016 të lidhur mes Titullarit të Autoritetit Kontraktor Bashkia Belsh dhe OE “F████” SHPK (Më hollësisht trajtuar në pikën 4.b, faqe 137-138 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

7.7.1. Rekomandim: Nga Bashkia Belsh të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **70,559 lekë pa TVSH**, nga operatori ekonomik “F████” SHPK në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën nr. - prot datë 15.08.2016 me objekt “Përmirësimi i kushteve të banimit të komunitetit Rom/Egjiptian”, Belsh, vlerë kjo e cila përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore si rrjedhojë e likuidimit të punimeve të pakryera në fakt apo prej mos ndryshimit të zërave në situacion sipas zërit faktit.

Menjëherë

8.8. Gjetje nga auditimi: Në tenderin me objekt “Sistemim asfaltim rruga Belsh-Qafshkallë”, me fond limit 57,999,000lekë pa TVSH zhvilluar në vitin 2016, KVO ka kualifikuar dhe shpallur fitues OE“V████ H████” SHPK, me vlerë të ofertës ekonomike 50,403,215 lekë pa TVSH i cili nuk i plotëson kriteret e vendosura në DST dhe, ka s’kualifikuar padrejtësisht BOE “A████ K████ SHPK & B████ SHPK”, me vlerë të ofertës ekonomike 39,948,344 lekë pa TVSH i cili plotëson kriteret e vendosura në DST, duke shkaktuar **dëm ekonomik në vlerën 10,454,871 lekë**, si diferencë midis dy ofertave (50,403,215 -39,948,344). Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenin 1, pika b, d, dh; nenin 2, pika a, c; nenin 53 pika 3; 5; nenin 55, të ligjit 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenin 56 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe 67-71 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

8.8.1. Rekomandim: Bashkia Belsh, të marrë masa dhe të ndjekë të gjitha procedurat e nevojshme ligjore për arkëtimin e vlerës **10,454,871 lekë** nga personat e mëposhtëm:

z. H████ T████ drejtor i bujqësisë, në cilësinë e kryetarit të KVO, për vlerën **3,484,957 lekë**;

z. H████ Xh████ me detyrë ish përgjegjës i urbanistikës, ndërprerë marrëdhëniet e punës, në cilësinë e anëtarit të KVO, për vlerën **3,484,957 lekë**;

zj. I████ H████ me detyrë ish juriste, ndërprerë marrëdhëniet e punës, në cilësinë e anëtarit të KVO, për vlerën **3,484,957 lekë**.

Menjëherë

9.9. Gjetje nga auditimi: Në tenderin me objekt “Skema e Ujitjes e Fushës Cestie (Degëzimi Kosove) Pjesshëm”, me fond limit 11,378,173 lekë pa TVSH zhvilluar në vitin 2017, KVO ka kualifikuar dhe shpallur fitues BOE “F████” SHPK & “Sh████”, me vlerë të ofertës ekonomike 10,094,975 lekë pa TVSH i cili nuk i plotëson kriteret e vendosura në DST dhe, ka s’kualifikuar padrejtësisht OE “A████” SHPK me vlerë të ofertës ekonomike 9,346,275 lekë pa TVSH i cili plotëson kriteret e vendosura në DST, duke shkaktuar **dëm ekonomik në vlerën 748,700 lekë**, si diferencë midis dy ofertave (10,094,975 - 9,346,275). Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenin 1, shkronjat (b, d, dh) nenin 2, shkronjat (a, c), nenin 53 pika 3; nenin 55, të ligjit 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenin 56 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe 105-107 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

9.9.1. Rekomandim: Bashkia Belsh, të marrë masa dhe të ndjekë të gjitha procedurat e nevojshme ligjore për arkëtimin e vlerës **748,700 lekë** nga personat e mëposhtëm:

z. A████ N████ drejtor ekonomik, në cilësinë e kryetarit të KVO, për vlerën **249,576 lekë**;

z. E [REDACTED] B [REDACTED], me detyrë përgjegjës i urbanistikës, në cilësinë e anëtarit të KVO, për vlerën 249,576 lekë;

zj. I [REDACTED] H [REDACTED] me detyrë ish juriste, ndërprerë marrëdhëniet e punës, në cilësinë e anëtarit të KVO, për vlerën 249,576 lekë;

Menjëherë

10.10. Gjetje nga auditimi: Në tenderin me objekt “Blerje Automjet transporti inertesh dhe transporin e eskavatorit me zinxhira”, me fond limit 4,100,000 lekë pa TVSH zhvilluar në vitin 2017, KVO ka kualifikuar dhe shpallur fitues OE“F [REDACTED]” SHPK, me vlerë të ofertës ekonomike 4,090,000 lekë pa TVSH, i cili nuk i plotëson kriteret e vendosura në DST dhe ka s’kualifikuar padrejtësisht OE “P [REDACTED] I [REDACTED]” SHPK, me vlerë të ofertës ekonomike 3,890,000 lekë pa TVSH i cili plotëson kriteret e vendosura në DST, duke shkaktuar **dëm ekonomik në vlerën 200,000 lekë**, si diferencë midis dy ofertave (4,090,000-3,890,000). Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenin 1, shkronjat (b, d, dh) nenin 2, shkronjat (a, c), nenin 53 pika 3; ; nenin 55, të ligjit 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenin 56 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe 87-89 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

10.10.1. Rekomandim: Bashkia Belsh, të marrë masa dhe të ndjekë të gjitha procedurat e nevojshme ligjore për arkëtimin e vlerës **200,000 lekë nga 6 punonjës dhe ish punonjës, në vlerën 33.333 lekë seicili,:**

z. A [REDACTED] N [REDACTED], drejtor ekonomik, në cilësinë e kryetarit të KVO.

z.Q [REDACTED] R [REDACTED], me detyrë përgjegjës i shërbimeve, në cilësinë e anëtarit të KVO, për vlerën 33,333 lekë.

zj.I [REDACTED] H [REDACTED] me detyrë ish juriste, ndërprerë marrëdhëniet e punës, në cilësinë e anëtarit të KVO.

z. D [REDACTED] M [REDACTED], me detyrë përgjegjës i zyrës juridike, në cilësinë e kryetarit të komisionit të shqyrtimit të ankesës së operatorit ekonomik të skualifikuar.

Zj.R [REDACTED] H [REDACTED], me detyrë juriste, në cilësinë e anëtarit të komisionit të shqyrtimit të ankesës së operatorit ekonomik të skualifikuar,

Z. P [REDACTED] T [REDACTED] me detyrë specialist shërbimesh, në cilësinë e anëtarit të komisionit të shqyrtimit të ankesës së operatorit ekonomik të skualifikuar,

Menjëherë

11.11. Gjetje nga auditimi: Në Bashkinë Belsh për periudhën 2016-2017 në shpenzimet për paga, janë bërë pagesa të kundërligjshme **për 16 punonjës në vlerën totale 181,400 lekë**, dëm ekonomik për buxhetin e njësisë vendore, në kundërshtim me kërkesat e pikës 12, paragrafi V dhe lidhjes 2; 7 të VKM nr. 1619, datë 02.07.2008 “Për klasifikim e funksioneve e grupimin e njësisive të qeverisjes vendore, për efekt page dhe caktimin e kufijve të pagave të punonjësve të qeverisjes vendore” i ndryshuar me VKM nr.518, datë 16.08.2012, VKM nr.586, datë 17.07.2013, VKM nr.165, datë 02.03.2016 (Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe 34-35 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

11.11.1. Rekomandim: Bashkia Belsh, të marrë masa dhe të ndjekë të gjitha procedurat e nevojshme ligjore për arkëtimin e vlerës 181,400 lekë sipas listës së mëposhtme: M [REDACTED] Xh [REDACTED] për vlerën 12,458 lekë, E [REDACTED] B [REDACTED] për G [REDACTED] H [REDACTED] për vlerën 16,610 lekë, G [REDACTED] C [REDACTED] për vlerën 12,458 lekë, O [REDACTED] M [REDACTED] për vlerën 12,458 lekë, K [REDACTED] K [REDACTED] për vlerën 12,458 lekë, D [REDACTED] M [REDACTED] për vlerën 8,305 lekë, H [REDACTED] B [REDACTED] për vlerën 8,305 lekë, A [REDACTED] K [REDACTED] për vlerën 12,458 lekë, A [REDACTED] D [REDACTED] për vlerën 12,458 lekë, J [REDACTED] D [REDACTED] për vlerën 8,305 lekë, F [REDACTED] B [REDACTED] për vlerën 4,153 lekë, E [REDACTED] H [REDACTED] për vlerën 4,153 lekë, V [REDACTED] Ç [REDACTED] për vlerën 16,432 lekë.

Menjëherë

E-Mbi mos zbatimin e rekomandimeve të KLSH nga Bashkia BELSH.

1- Nga verifikimi rezulton se KLSH ka dërguar në Bashkinë Belsh, rekomandimet e auditimit me shkresën e saj nr. 06/9, datë 14.05.2018, protokolluar në Bashkinë Belsh me shkresën nr.1188 prot, datë 15.05.2018, ndërkohë nga Bashkia Belsh, nuk është kthyer përgjigje brenda afatit prej 20 ditësh, në kundërshtim me ligjin nr.154/2014, datë 27.11.2014 “Për funksionimin dhe organizimin e KLSH”, Neni 15, Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së, ku parashikohet se: Kontrolli i Lartë i Shtetit, sipas rastiit, në fillim, përgjatë dhe/ose në përfundim të veprimtarisë, duhet: j) të vendosë një afat kohor për zbatimin e rekomandimeve dhe të informohet nga subjektet e audituara ose institucionet më të larta rreth programeve të tyre, për të zbatuar rekomandimet e bëra sipas paragrafëve të mësipërm, brenda 20 ditëve nga data e marrjes së kërkesës.

2. Bashkia Belsh, nuk ka raportuar në KLSH mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afatit 6 muajor, ose më datën **14.11.2018**, (Rekomandimet janë dërguar me shkresën e KLSH nr. 06/9, datë 14.05.2018 dhe protokolluar në Bashkinë Belsh me shkresën nr.1188 prot, datë 15.05.2018), duke shkelur haptazi nenin 30, pika 2, e ligjit nr.154/2014 datë 27.11.2014 “Për funksionimin dhe organizimin e KLSH”, ku parashikohet se: Subjekti i audituar, brenda 6 muajve nga data e njoftimit të raportit të auditimit, i raporton Kontrollit të Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të dhëna.

3. Bashkia Belsh nuk ka hartuar planin e veprimit të zbatimit të rekomandimeve të dërguara nga KLSH me shkresën nr. 6/9, datë 14.05.2018, në kundërshtim edhe me ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, Neni 50-Auditimi i jashtëm, pika 5, ku parashikohet se: Për të gjitha raportet e auditimit të jashtëm, të kryera nga Kontrolli i Lartë i Shtetit apo auditues të tjerë ligjorë, kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore përgatit një plan veprimi për zbatimin e rekomandimeve të raportit të auditimit.

Nisur sa sipër, për mos zbatimin e rekomandimeve nga Bashkia Belsh, KLSH do t i përcjellë Sekretarit dhe Kryetarit të Këshillit Bashkiak Belsh, Raportin përfundimtar të auditimit të zbatimit të rekomandimeve dhe Vendimin e Kryetarit të KLSH, duke kërkuar që ta diskutojnë dhe analizojnë në Këshillin Bashkiak Belsh.

Në mbledhjen më të afërme të Këshillit Bashkiak Belsh

F. TË TJERA:

Për të gjitha rekomandimet që konsiderohen në proces sipas rezultateve të këtij auditimi, kërkojmë dhe inkurajojmë përsheptimin e plan veprimit për realizimin e plotë të tyre brenda 20 ditëve nga marrja e këtij Raporti Përfundimtar Auditimi.

Pavarësisht auditimit që ne kemi kryer për zbatimin e rekomandimeve, ju kujtojmë që në mbështetje të nenit 30, pika 2 dhe 3 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, **brenda 20 ditëve nga data e marrjes së kërkesës**, duhet të raportoni me shkrim pranë KLSH, mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve tona dërguar me shkresat përkatëse si dhe ju bëjmë me dije se zbatimi i rekomandimeve do të jetë pjesë e auditimit të radhës nga KLSH, në subjektin Tuaj.

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Vetëqeverisjes Vendore.

Shënim 1: Pjesë integrale e këtij Vendim janë edhe 4 Anekset respektivisht nr. 1 deri 4 Për rekomandimet dhe realizimi sipas llojeve të masave të rekomanduara nga Kryetari i KLSH në vendimet respektive.

BUJAR LESKAJ

KRYETAR